

KOMPANIA PËR MENXHIMIN E MBETURINAVE NË KOSOVË SH.A



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A.

Kosovo Landfill Management Company J.S.C.


Rr. Sheshi i Lirisë, p.n. Fushë Kosovë 12000, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552

www.kmdk-ks.org



PLANI I BIZNESIT 2025-2027



Tetor 2024
Fushë Kosovë

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive	5
1. Përshkrimi i përgjithshëm	6
1.1 Vizioni dhe misioni	6
1.2 Qëllimi dhe objektivat	6
1.2.1 Objektivat e KMDK-së për periudhën 2025-2027	7
1.2.2 Objektivat SMART të KMDK për periudhën 2025-2027	8
1.3 Filozofia dhe vlerat e të bërit biznes	10
1.4 Statusi ligjor	10
1.5 Historiku i ndërmarrjes	10
1.6 Pozicionimi i KMDK-së në sektorin e menaxhimit të mbeturinave	11
2. Produktet dhe shërbimet	12
2.1 Shërbimet aktuale komerciale	12
2.2 Shërbimet e zgjeruara komerciale	13
3. Plani i marketingut	14
3.1 Objektivat e marketingut për vitin 2025	14
3.2 Marrëdhëniet me publikun	15
3.3 Analiza SWOT	15
4. Organizimi dhe menaxhimi	16
4.1 Struktura e ndërmarrjes	16
4.2 Ekipi menaxhues	17
4.3 Struktura organizative	17
4.4 Rekrutimi i stafit	18
4.5 Plani i personelit	20
4.6 Plani i trajnimeve	20
4.7 Struktura e të punësuarve dhe kompensimi	21
4.8 Këshilltarët e jashtëm	21
4.9 Menaxhimi i burimeve njerëzore	21
5. Plani operacional për KMDK 2025-2027	22
5.1 Prioritetet operative për vitin 2025:	22
5.2 Prioritetet operative për vitin 2026:	23
5.3 Prioritetet operative për vitin 2027:	24
5.4 Plani investiv i ndërmarrjes	24
5.4.1 Plani operacional i KMDK për fazat e programit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta II-IV (2024-2028)	24
a) Faza 1: Përgatitja e dizajnit dhe dokumenteve tenderuese	25
b) Faza 2: Asistenca gjatë tenderimit (2025-2028)	25
c) Faza 3: Implementimi dhe zbatimi i projekteve (2026-2028)	26
d) Përputhshmëria me standardet mjedisore dhe sociale	26
e) Sfidat	26
5.4.2 Investimi në shërbimet e reja	27
6. Menaxhimi i riskut (Kufizimet dhe Rreziqet)	29
6.1.1 Paqartësitë rreth përcaktimit të lokacionit të deponisë qendër	29
6.1.2 Mosndërtimi i sistemit dhe metodologjisë së përcaktimit të tarifës	29

6.1.3 Rreziqet në tranzicion	30
6.1.4 Rreziku financiar	30
6.1.5 Deponitë ilegale	30
6.2.1 Faktorët e brendshëm (Negativ)	30
6.2.2 Faktorët e brendshëm (Pozitiv)	30
6.2.3 Faktorët e jashtëm	30
6.3 Risku për burime njerëzore	31
6.4 Risku ligjor	31
6.5 Risku financiar	32
7. Plani financiar	32
7.1 Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025-2027	32
7.2 Planifikimi buxhetor për vitin 2025	35
7.3 Shpenzimet e deponive sanitare në KMDK	39
7.4 Shpenzimet operationale	42
7.5 Pagat në KMDK	45
7.6 Vlera dhe sasia e mbeturinave për vitin 2025	46
7.7 Investimet	48

Lista e shkurtesave (Akronimet)

Aksionari	Qeveria e Republikës së Kosovës
AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BD	Bordi i Drejtorëve
DS	Deponi Sanitare
EWK	Klasifikimi Evropian i Mbeturinave
EWL	Lista Evropiane e Mbeturinave
KA	Komisioni i Auditimit
KE	Kryeshefi Ekzekutiv
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
LNP	Ligji për Ndërmarrjet Publike
LM	Ligji për Mbeturina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
ME	Ministria e Ekonomisë
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MIMO	Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave Organike
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave të Ngurta
MM	Mbeturinat Medicinale
MMB	Menaxhimi i Mbeturinave dhe Burimeve
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MNK	Mbeturinat e Ngurta Komunale
MNRR	Mbeturinat e Ndërtimit dhe Rrënit
MPEE	Mbeturinat nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike
MRR	Mbeturinat e Rrezikshme
NPK	Nënproduktet e Kafshëve

NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
O&M	Operimi dhe Mirëmbajtja
PB	Plani i Biznesit
PMM	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave
QN	Qendër e Ndarjes (qendër e lënes për riciklim)
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SHSP	Shëndeti dhe Siguria në Punë
SIM	Sistemi Informativ Mjedisor
SMIM	Strategjia / Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave
SMIMK	Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë
UA	Udhëzimi Administrativ
WBIF	Korniza e Investimeve për Ballkanit Perëndimor

Përmbledhja ekzekutive

Plani i Biznesit (PB) është një udhërrëfyes strategjik për Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) për periudhën 2025-2027. Ky dokument përcakton misionin, objektivat dhe rezultatet e pritshme të operacioneve të KMDK-së. Plani është përpiluar në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe është në përputhje me kornizën ligjore që rregullon menaxhimin e integruar të mbeturinave në nivel qendror dhe komunal, me fokus në menaxhimin e deponive sanitare në Republikën e Kosovës.

Ekzekutimi me sukses i këtij plani varet nga implementimi i strategjisë së dyfishtë financiare. Kompania synon të jetë kryesisht e vetëfinancuar për zhvillimin e operacioneve të veta duke shfrytëzuar të ardhurat vetanake. Megjithatë, për segmentet që përfshijnë investime të konsiderueshme dhe realizimin e strategjive kombëtare, kërkohet mbështetje e jashtme financiare dhe asistencë teknike nga aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe donatorët. Kjo mbështetje e jashtme është e nevojshme për shkak të tarifave aktuale të ulëta, të cilat nuk mbulojnë në mënyrë adekuate investimet kapitale afatgjata të kërkuara për operacione të qëndrueshme të ndërmarrjes.

Ky Plan Biznesi është formuluar për të lehtësuar planifikimin dhe ekzekutimin financiar për vitet 2025-2027, i ankoruar në parametrat financiarë më realistë që përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet. PB harmonizohet me dokumentet strategjike shtetërore, duke përfshirë:

- Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2024-2035) dhe Plani i Veprimit (2024-2026) dhe strategjia paraprake
- Projektionet e investimeve të ekstrapoluara nga studimet e fizibilitetit për KMDK sh.a. për periudhën 2024-2026,
- Dokumenti fillestar për implementimin e Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngjurma II-IV.

Ky plan është hartuar me përpikëri, duke u mbështetur në të dhënat analitike, krahasimet historike dhe statusin aktual operacional të kompanisë. PB është përpiluar për të inkorporuar standardet e industrisë dhe praktikatat më të mira për të arritur misionin e kompanisë për zhvillimin e qëndrueshëm.

Ky Plan Biznesi është i adaptueshëm, me parashikime për një rishikim vjetor për të siguruar përputhshmëri me nevojat në zhvillim të Kompanisë dhe në përputhje me rregulloret ligjore në zhvillim e sipër dhe implementimin e projekteve investive nga donatorët.

1. Përshkrimi i përgjithshëm

1.1 Vizioni dhe misioni

Vizioni i KMDK-së është të jemi lideri kryesor në menaxhimin e sistemit të integruar të mbeturinave dhe ekonominë qarkorë, e dalluar për angazhimin tonë të palëkundur për profesionalizëm, transparencë dhe mbrojtjes së mjedisit. Të japim kontribut qendror në uljen e ndikimit negativ të mbeturinave në mjedis dhe njëkohësisht të zgjerojmë aktivitetet tona duke krijuar mundësi të reja biznesi dhe punësimi në vend. Ne do ta arrijmë këtë vizion duke aplikuar teknologjitë më të avancuara, duke ofruar shërbime superiore dhe duke vendosur standardet më të larta për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

Misioni i KMDK-së është të ofrojë shërbime profesionale, transparente të menaxhimit të mbeturinave dhe deponive që kanë prioritet mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Ne përpiqemi të aplikojmë teknologji moderne që përmirësojnë operacionet tona dhe na mundësojnë të ofrojmë shërbime me cilësi të lartë. Përkushtimi ynë ndaj përsosmërisë siguron se ne të jemi bërë pikë referimi për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave duke kontribuar për një të ardhme më të pastër dhe më të gjelbër për të gjithë.

1.2 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor afatmesëm i KMDK-së është ngritja e cilësisë dhe zgjerimi i gamës së shërbimeve në menaxhimin e mbeturinave, shërbimeve financiare si dhe komerciale në Kosovë dhe më gjerë, duke siguruar vet-qëndrueshmëri financiare.

Synojmë të ofrojmë shërbime cilësore të menaxhimit të deponive sanitare dhe të trajtimit të mbeturinave duke u përpjekur që:

- Të aplikojmë qeverisje cilësore korporative në përputhje me Kodin e Etikës për Qeverisjen Korporative dhe bazën ligjore me synim të:
 - Arritjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar,
 - Ofritit të qasjes transparente në afarizmin e kompanisë,
 - Aplikimit të standardeve të avancuara në menaxhimin financiar dhe operacional.
- Të implementojmë strategjinë kombëtare për menaxhimin e integruar të mbeturinave përfshirë ekonominë qarkorë.
- Të bëjmë trajtimin profesional të mbeturinave për të siguruar shëndetin dhe pastërtinë në Republikën e Kosovës.
- Të rrisim dhe intensifikojmë bashkëpunimin me klientët duke iu përshtatur nevojave të tyre.
- Të kontribuojmë në vetëdijësimin dhe edukimin publik për trajtimin e përgjegjshëm të mbeturinave në Republikën e Kosovës përfshirë luftimin e hedhjes ilegale të mbeturinave dhe deponive ilegale.
- Të implementojmë Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) si më poshtë:
 - Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme (SDG 11): synojmë të ofrojmë shërbime cilësore të trajtimit dhe deponimit të mbeturinave për qytetarët, duke mundësuar qytete dhe komunitete të qëndrueshme në Republikën e Kosovës duke ulur ndikimin negativ mjedisor për kokë banori të vendbanimeve.
 - Prodhimin dhe Konsumimin e Përgjegjshëm (SDG 12): synojmë të kontribuojmë në uljen e gjenerimit të mbeturinave duke rritur parandalimin, reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave.
 - Teknologjitë e Fundit për Trajtimin e Mbeturinave (SDG 9): synojmë të aplikojmë teknologjitë më të fundit inovative për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.

- Veprimi për Klimën (SDG 13): Misioni ynë është të kontribuojmë në veprimet për klimën duke ofruar zgjidhje të favorshme për mjedisin për menaxhimin e mbeturinave dhe duke minimizuar ndikimin mjedisor të mbeturinave.
- Të krijojmë dhe mirëmbajmë raporte me ndërmarrjet simotra në rajon dhe botë për të siguruar shkëmbimin e përvojave dhe teknologjive.

1.2.1 Objektivat e KMDK-së për periudhën 2025-2027

Përgjatë periudhës 2025-2027, KMDK ka këto objektiva strategjike:

1. Planifikimi dhe ngritja e kapaciteteve të reja moderne të deponimit nëpërmjet Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II-IV. Planifikojmë të implementojmë pa vonesa të paarsyeshme zbatimin e programit për deponitë sanitare të Gjilanit, Prizrenit, Rajonit Qendër, Podujevës, Pejës si dhe rehabilitimi deponisë sanitare të Istogut dhe stacionit të transferit në Ferizaj.
2. Dizajnimi i shërbimeve shtesë të trajtimit të mbeturinave dhe zgjerimi territorial i aktivitetit me synim rritjen e kontributit të KMDK-së drejt implementimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave.
3. Mirëmbajtja e kapacitetit ekzistues të deponimit dhe përmirësimi i cilësinë së shërbimit në deponitë ekzistuese gjatë tranzicionin deri në ndërtimin e deponive të reja, duke përdorur metoda të përmirësuara të menaxhimit të mbeturinave dhe duke u kujdesur për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësuar shërbimet.
4. Rritja e kapacitetit profesional të ndërmarrjes duke strukturuar ndërmarrjen dhe rekrutuar staf profesional që KMDK të jetë e aftë të kryej misionin e saj dhe të përshtatet me nevojat dhe mundësitë që krijon Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave. Krijimi i akomodimit permanent për zyrën qendrore të ndërmarrjes.
5. Përmirësimi i proceseve të brendshme dhe arritja e përshtatshmërisë së ndërmarrjes me kërkesat rregullative dhe praktikat më të mira. Synojmë përmirësimi i raportit me klientët dhe eliminimin e borxheve ndaj ndërmarrjes.
6. Evidentimi dhe adresimi i risqeve dhe rreziqeve me të cilat përballlet ndërmarrja dhe mjedisi përreth deponive sanitare.
7. Ribrandimi i ndërmarrjes dhe pjesëmarrja aktive në procesin e avancimit të politikave publike në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe rritjes së vetëdijes publike për nevojën për avancim të kualitetit të menaxhimit të mbeturinave në vend drejt ekonomisë qarkore.

1.2.2 Objektivat SMART të KMDK për periudhën 2025-2027

1. Zhvillimi i kapaciteteve të reja moderne të deponimit:

- **Specifike:** Ndërtimi i deponive sanitare në Gjilan, Prizren, Rajonin Qendër, Podujevë, Pejë dhe rehabilitimi i deponisë së Istogut dhe stacionit të transferit në Ferizaj.
- **E matshme:** Plotësimi i 100% të kapaciteteve të planifikuara brenda periudhës 2025-2027.
- **E arritshme:** Buxheti dhe burimet teknike janë planifikuar dhe siguruar për secilin projekt.

- **Relevante:** Ndërtimi dhe rehabilitimi i deponive është thelbësor për zbatimin e strategjisë së integruar të menaxhimit të mbeturinave.
- **E lidhur me kohën:** Zbatimi i deponive të reja duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2027.

2. Dizajnimi dhe ofrimi i shërbimeve të reja të trajtimit të mbeturinave:

- **Specifike:** Krijimi i të paktën 3 shërbimeve të reja për trajtimin e mbeturinave (p.sh., ndarja e mbeturinave, kompostimi, gjenerimi i energjisë nga gaz natyror).
- **E matshme:** Rritja me 15% e të hyrave të ndërmarrjes nga shërbimet e reja një vit pas implementimit të shërbimeve të reja.
- **E arritshme:** Shërbimet do të zhvillohen në bashkëpunim me aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë.
- **Relevante:** Shërbimet e reja përmirësojnë kontributin e KMDK-së për implementimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave.
- **E lidhur me kohën:** Këto shërbime të reja duhet të jenë operacionale deri në fund të vitit 2026.

3. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i kapacitetit ekzistues të deponimit:

- **Specifike:** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve (pranimi, kompaktimi dhe mbulimi) dhe implementimi i metodave të avancuara për uljen e ndikimit në mjedis në deponitë ekzistuese.
- **E matshme:** Rritje në 100% të kompaktimit dhe mbulim mujor i mbeturinave.
- **E arritshme:** Trajnimi i stafit dhe furnizimi me pajisje teknologjike moderne do të sigurohet për çdo deponi.
- **Relevante:** Këto përmirësime janë kyçe për mbajtjen e shërbimeve të vazhdueshme deri në ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- **E lidhur me kohën:** Mirëmbajtja e përmirësuar duhet të vazhdojë nga TM1 të vitit 2025 dhe të jetë e qëndrueshme deri në vitin 2027.

4. Rritja e kapacitetit profesional të ndërmarrjes:

- **Specifike:** Rekrutimi i profesionistëve të rinj dhe struktura e re organizative e ndërmarrjes.
- **E matshme:** Kryerja me sukses e procesit të ristrukturimit sipas nevojave të ndërmarrjes.
- **E arritshme:** KMDK do të sigurojë akomodimin permanent për administratën qendrore.
- **Relevante:** Rritja e kapacitetit profesional është e domosdoshme për përmbushjen e misionit dhe përshtatjen me Strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave.
- **E lidhur me kohën:** Procesi i ristrukturimit do të përfundojë deri në TM2 të vitit 2025.

5. Përmirësimi i proceseve të brendshme dhe përputhshmëria me kërkesat rregullative:

- **Specifike:** Implementimi i sistemit të ri të menaxhimit të klientëve dhe proceset për eliminimin e borxheve.
- **E matshme:** Revidimi i tërë rregullativës së brendshme dhe eliminimi i borxheve ndaj ndërmarrjes.

- **E arritshme:** Zbatimi i një sistemi ERP dhe ndjekja e procedurave më të mira rregullative dhe financiare.
- **Relevante:** Proceset e përmirësuara do të ndikojnë direkt në qëndrueshmërinë financiare dhe operative të ndërmarrjes.
- **E lidhur me kohën:** Përmirësimet duhet të implementohen plotësisht deri në fund të vitit 2025.

6. Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve:

- **Specifike:** Krijimi i një sistemi për monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve në deponitë sanitare.
- **E matshme:** Raportimi i rreziqeve dhe masave parandaluese do të rritet me 50% deri në vitin 2027.
- **E arritshme:** Stafi do të trajnohet për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive.
- **Relevante:** Menaxhimi i rreziqeve është kritik për sigurinë e punëtorëve dhe mbrojtjen e mjedisit përreth deponive.
- **E lidhur me kohën:** Sistemi i menaxhimit të rreziqeve duhet të jetë funksional deri në Q4 të vitit 2025.

7. Pjesëmarrja aktive në përmirësimin e politikave publike dhe ndërgjegjësimi publik:

- **Specifike:** Ribrandimi i ndërmarrjes, përmirësimi i prezencës së në internet dhe media sociale dhe pjesëmarrja në 5 procese të formulimit të politikave publike në vit.
- **E matshme:** Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe përfshirja e KMDK-së në formulimin e politikës shtetërore të përcaktimit të tarifave për deponim.
- **E arritshme:** Aktivitetet do të organizohen në bashkëpunim me OJQ-të dhe aktorët e qeverisë.
- **Relevante:** Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i politikave do të ndihmojë për zbatimin më të mirë të strategjisë së mbeturinave drejt ekonomisë qarkore.
- **E lidhur me kohën:** Ribrandimi do të kryhet deri në fund të TM2 2025, ndërsa diskutimet për politikëbërje do të zhvillohen çdo vit nga 2025-2027.

1.3. Filozofia dhe vlerat e të bërit biznes

Filozofia dhe vlerat e KMDK bazohen në si më poshtë:

1. Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A. përqafon dhe promovon vlerat më të larta të biznesit, duke ndjekur një filozofi gjithëpërfshirëse që nxit bashkëpunimin me shoqërinë dhe respektin për mjedisin përreth.
2. KMDK Sh.A. zbaton politika zhvillimore kreative që synojnë të identifikojnë mundësitë e të bërit biznes me efektivitet dhe efikasitet duke ofruar shërbim superior për vendin dhe shtim të vlerës për ndërmarrjen.
3. Në angazhohemi për të krijuar një ambient pune të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të drejtë, ku secili individ të ndihet i respektuar dhe i vlerësuar. Kompania respekton standardet më të larta të etikës profesionale, përfshirë ndershmërinë, integritetin, paanësinë dhe profesionalizmin, të cilat udhëheqin çdo veprim dhe vendim. Duke zbatuar me rigorozitet

kodin e sjelljes dhe procedurat disiplinore, ne sigurojmë një mjedis pune të drejtë dhe të përgjegjshëm për të gjithë punonjësit tanë.

1.4 Statusi ligjor

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është shoqëri aksionare (me shkurtim KMDK SH.A) e themeluar në kuadër të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. KMDK SH.A është regjistruar me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve si shoqëri aksionare me 100% pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare. Kompania kryen aktivitetet e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, aktet ligjore të brendshme dhe dokumentet strategjike.

1.5 Historiku i ndërmarrjes

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A u themelua në vitin 2005 nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa deponitë u ndërtuan nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER). Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është kompania qendrore për menaxhimin e deponive në nivel vendi.

Funksionimi dhe menaxhimi i deponive sanitare janë të lidhura ngushtë me respektimin dhe zbatimin e rregullave dhe kriterëve mjedisorë, siç janë paraparë në dispozitat ligjore përkatëse. Kompania synon të avancojë në vazhdimësi kujdesin për mjedisin në çdo aspekt të operacioneve të saj.

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë u themelua në vitin 2005, si rezultat i bashkëpunimit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, me Agjencinë Evropiane për Rindërtim (AER) që financoi ndërtimin e deponive sanitare si pjesë e përpjekjeve për të krijuar një infrastrukturë të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me standardet mjedisorë të BE-së.

KMDK menaxhon deponitë për hedhjen përfundimtare të mbeturinave në Kosovë, duke përfshirë ato në Prishtinë, Prizren, Gjiçan dhe Podujevë. Gjithashtu, kompania administron një stacion transferi në Ferizaj. Deponia më e madhe, ajo e Prishtinës, u përfundua në vitin 2006 dhe shërben rreth 730,000 banorë, duke qenë një nga komponentët më të rëndësishëm të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

Për shkak të menaxhimit të dobët dhe mungesës së investimeve adekuate, deponitë sanitare të KMDK-së gradualisht degradoan dhe i humbën licencat adekuate. Tanimë deponitë operojnë nën standardet adekuate, përtej jetëgjatësisë së tyre të planifikuar dhe me teknologji të pakët e të stërvjetëruar.

Si operator qendror, tani misioni i KMDK-së shtrihet përtej hedhjes së mbeturinave, për të siguruar sigurinë mjedisorë, respektimin e kuadrit ligjor dhe kujdesin për mbylljen dhe menaxhimin pas mbylljes së deponive kur përfundon cikli i tyre jetësor. Kjo përfshin përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur standardet e BE-së dhe për të kontribuar në mirëqenien mjedisorë të Kosovës duke integruar praktikatat më të mira në menaxhimin e deponive dhe mbrojtjen e mjedisit

1.6 Pozicionimi i KMDK-së në sektorin e menaxhimit të mbeturinave

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë luan një rol thelbësor në zbatimin e Strategjisë së Integruar për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë për periudhën 2024-2035. Përgjegjësitë e KMDK-së janë ngushtësisht të lidhura me objektivat strategjike kombëtare për modernizimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave dhe tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie rrethore në

përputhje me standardet evropiane. Si entiteti kryesor që mbikëqyr operacionet e deponive në Kosovë, KMDK është thelbësorë për arritjen e objektivave afatgjata të strategjisë.

Strategjia e pozicionon KMDK-në si një aktor kyç në avancimin e sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Liderhipi i saj në modernizimin e deponive, bashkëpunimi ndërkomunal, mbështetja për praktikat e ekonomisë qarkore dhe angazhimi për qëndrueshmërinë financiare do të jenë vendimtare për ndihmën që Kosova të arrijë objektivat e saj për menaxhimin e mbeturinave dhe të përputhet me standardet evropiane. Përmes këtyre përpjekjeve, KMDK do të luajë një rol thelbësor në drejtimin e përparimit të vendit drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe efikasitetit të burimeve.

Modeli i menaxhimit të centralizuar të deponive sanitare është një përparësi e madhe e Kosovës për dallim nga shtetet e tjera të rajonit. Ky pozicionim qëndror, mundëson menaxhim shumë më efikas dhe efektiv të deponive sanitare dhe e vë KMDK-në në qendër për zgjerim të veprimtarisë në fusha që më së miri mund të menaxhohen nga niveli qëndror, në përputhje me parimin e subsidiaritetit të BE-së.

Në zemër të strategjisë është nevoja për zhvillimin e infrastrukturës, dhe KMDK është e ngarkuar të sigurojë që deponitë rajonale të përmbushin standardet mjedisore moderne. Këto përmirësime, të cilat janë të nevojshme për përputhje me rregulloret e BE-së, synojnë përputhjen e plotë deri në vitin 2027. KMDK është pozicionuar si një lider në efikasitetin operativ dhe mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar praktika të sigurta dhe të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave në gjithë Kosovën.

Ndërsa Kosova përparon drejt një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave, roli i KMDK bëhet edhe më i rëndësishëm. Strategjia parashikon një kalim nga modeli bazik i asgjësimit të mbeturinave në një qasje më gjithëpërfshirëse që përfshin rikuperimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave. KMDK do të luajë një rol kyç në këtë tranzicion, duke mbikëqyrur ngritjen e objekteve të avancuara siç janë impiantet për Trajtimin Mekanik-Biologjik (MBT). Këto impiante do të ndihmojnë në reduktimin e varësisë nga deponitë duke prodhuar karburant të derivuar nga mbeturinat (RDF), i cili mund të përdoret në proceset e rikuperimit të energjisë, duke kontribuar kështu në një model më të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave.

Për më tepër, KMDK është në qendër të ambicieve të Kosovës për të kaluar drejt një ekonomie qarkore. Kompania do të ndihmojë në uljen e varësisë së vendit nga deponitë duke promovuar rikuperimin, riciklimin dhe rikuperimin e energjisë nga mbeturinat. Përmes këtyre përpjekjeve, KMDK mbështet objektivin shtetëror të zvogëlimit të sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi, duke nxitur një sistem më të qëndrueshëm dhe më efikas në përdorimin e burimeve.

Përveç përgjegjësisë së saj operacionale, KMDK pritet të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet komunave, një aspekt i rëndësishëm për arritjen e efikasitetit në menaxhimin e mbeturinave. Duke koordinuar dhe mbështetur shërbimet e mbledhjes dhe asgjësimit të mbeturinave në rajone të ndryshme, KMDK mund të sigurojë që këto shërbime të ofrohen në mënyrë më efektive dhe më ekonomike, duke sjellë përfitime për komunat dhe komunitetet që ato shërbejnë. Ky qasje rajonale do të përmirësojë planifikimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbeturinave, duke nxitur rezultate më të mira për të gjithë vendin.

Qëndrueshmëria financiare është gjithashtu një fokus kryesor për KMDK. Strategjia thekson nevojën që kompania të përmirësojë mekanizmat e kthimit të kostos, duke siguruar që kostot operative të mbulohen përmes strukturave të duhura tarifore për shërbimet e deponive. Për më tepër, KMDK do të angazhohet me sektorin privat, duke inkurajuar investimet në infrastrukturën dhe shërbimet e menaxhimit të mbeturinave. Duke nxitur pjesëmarrjen e sektorit privat, KMDK do të ndihmojë në përmbushjen e

kërkesës në rritje për investime në menaxhimin e mbeturinave, duke mbështetur objektivat më të gjera të strategjisë.

2. Produktet dhe shërbimet

2.1 Shërbimet aktuale komerciale

Vëllimi i mbeturinave të ngurta komunale në nivel vendi vlerësohet të jetë rreth 600,000 ton në vit të (MSW), nga të cilat KMDK pranon rreth 400,000t. Kompania aktualisht ofron shërbime të menaxhimit të deponive sanitare, por synon të zgjerojë gamën e shërbimeve duke përfshirë trajtimin e mbeturinave të pranuar dhe menaxhimin e deponive sanitare pas mbylljes së tyre. KMDK vepron brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, duke synuar përputhshmëri me standardet dhe rregulloret mjedisore.

Për të garantuar operacione të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e kërkuara, kompania synon të pajiset me të gjitha lejet, autorizimet, licencat dhe miratimet administrative të nevojshme për këto veprimtari. Ky proces është një përgjegjësi e rëndësishme që trajtohet me profesionalizëm dhe kujdes, duke qenë vendimtar për të siguruar që operacionet tona janë të sigurt dhe të ligjshme.

Në të njëjtën kohë, kemi për qëllim të intensifikojmë aktivitetet dhe investimet në trajtimin e mbeturinave me fokus të veçantë të respektimi i mjedisit. Kjo përfshin jo vetëm menaxhimin efektiv të deponive dhe shërbimet pas mbylljes së tyre, por edhe përmirësimin e metodave të trajtimit të mbeturinave të pranuar. Duke aplikuar teknologjitë më të fundit dhe metodat inovative të trajtimit, synojmë të sigurojmë që mbeturinat të trajtohen në mënyrë të përgjegjshme dhe të promovojmë ripërdorimin dhe riciklimin maksimal të mundshëm.

KMDK si veprimtari primare e ka:

1. 3900 Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave.

Aktivitetet sekondare:

1. 3811 Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme
2. 3821 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme.
3. 7511 Veprimtaria e shërbimeve të përgjithshme publike.
4. Shërbimi i deponimit të mbeturinave Komunale në Deponitë Sanitare, Regjionale.

Kompania menaxhon me katër deponi sanitare dhe një stacion transferi si më poshtë:

Deponia Sanitare e Mirashit – Prishtinë,

Deponia Sanitare e Landovicës – Prizren,

Deponia Sanitare e Velekincës – Gjiçan,

Deponia Sanitare e Dumnicës – Podujevë,

Stacionin e Transferit në Gërlicë – Ferizaj.

Gjatë vitit 2025 planifikohet që me KMDK-në të shkrihet edhe Deponia Sanitare në Lutogllavë, Pejë dhe ajo në Zvecan.

2.2 Shërbimet e zgjeruara komerciale

Strategjia përcakton një objektiv të qartë për të ulur sasinë e mbeturinave komunale që përfundojnë në deponi. Deri në vitin 2030, Kosova synon të reduktojë sasinë e mbeturinave komunale të deponuara nën 30%, me synim që të reduktohet më tej në më pak se 10% deri në vitin 2045. Njëkohësisht, strategjia parasheh rritjen e ndjeshme të shkallës së riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave komunale. Deri në vitin 2030, 20% e mbeturinave komunale duhet të përgatiten për ripërdorim dhe riciklim, duke u rritur në 50% deri në vitin 2035 dhe duke arritur në 60% deri në vitin 2045. Këto objektiva shtetërore paraqesin rrezik operacional për KMDK-në por njëkohësisht edhe mundësi të mëdha zhvillimi.

Në përputhje me trendin, KMDK SH.A. planifikon që t'i zgjerojë shërbimet e saj duke ofruar shërbimet në vijim:

1. Ndarja e mbeturinave: Rreth 40% e mbeturinave komunale konsiderohen të reciklueshme. Tani për tani mbeturinat e përziera grupohen duke mos u marrë vlerën. KMDK është e pozicionuar shumë mirë të kryej ndarjen e mbeturinave dhe kthimin e mbeturinave të reciklueshme në qarkullim duke krijuar kështu mundësi të madhe afariste për vetë dhe duke stimuluar sektorin e riciklimit dhe ripërdorimit në vend.

2. Gjenerimin e energjisë nga gasi: Deponitë tona përmbajnë sasi të mëdha të mbeturinave të akumuluar me një përmbajtje të lartë organike që paraqet mundësi për gjenerim të energjisë nga gasi. Investimi në këtë fushë do të ketë ndikim të madh në ruajtjen e mjedisit duke reduktuar ndjeshëm gazrat serrë dhe do të krijojë burim të ri të ardhurash për KMDK-në.

3. Mbështetja për komunat: Pozicionimi i KMDK-së si ndërmarrje publike qendrore, ia mundëson kompanisë të zhvillojë shërbime mbështetëse për komunat si furnizime me makineri dhe pajisje për përsheptimin e tranzicionit drejt ekonomisë qarkore. Strategjia synon të sigurojë që shërbimet e grumbullimit të ndarë të mbeturinave të ofrohen për të paktën 80% të popullsisë deri në vitin 2030, me mbulimin e plotë (100%) deri në vitin 2045. Roli i KMDK-së mund të jetë qenësor në mbështetjen e komunave në arritjen e këtyre objektivave.

4. Trajtimi i mbeturinave organike: Mbi 40% e mbeturinave të pranuar konsiderohet të jenë organike. Gruposja e patrajtuar e këtyre mbeturinave krijon risqe të mëdha afatgjata. Trajtimi i mbeturinave organike dhe kompostimi i tyre paraqet edhe mundësi afariste edhe adresim i problemeve operative.

5. Gjenerimi i energjisë nga mbeturinat e paraciklueshme: KMDK është mirë e pozicionuar të kapë mundësinë e gjenerimit të energjisë nga mbeturinat e paraciklueshme.

6. Pranimi dhe trajtimi i mbeturinave nga ndërtim-rrënimet: KMDK ka nevojë për sasi të mëdha të materialit inert për të siguruar zhvillimin normal të rrjedhës së operimeve në deponi. Si ndërmarrje qendrore me pasjen në posedim të deponive sanitare, KMDK është e pozicionuar shumë mirë për zhvillimin e shërbimit të pranimit, trajtimit dhe shitjes së materialit inert që do të adresonte një problem madhor për vendin, do të adresonte nevojat e veta dhe do të krijonte një burim të ri të të hyrave. Vlerësohet se rreth 620,000 metra kub mbeturina nga ndërtimi dhe prishja e objekteve, që i korrespondon 515,000 ton, gjenerohen çdo vit në Kosovë. Objektivat e vendit për mbeturinat nga ndërtimi dhe prishja e objekteve përfshijnë arritjen e 40% ripërdorim dhe riciklim deri në vitin 2030 dhe 50% deri në vitin 2035, me një objektiv përfundimtar prej 70% për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim të materialeve.

7. Pranimit dhe trajtimi i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave: KMDK është mirë e pozicionuar të zhvillojë projekte për zgjidhjen e adresimit të problemeve të ndryshme të pa-adresuara në vend nga fraksione të ndryshme të mbeturinave si mbeturinat shtazore, mbeturinat e rrezikshme, asbesti, gomat etj.

3. Plani i marketingut

3.1 Objektivat e marketingut për vitin 2025

Për shkak të gjendjes së rënduar të deponive sanitare dhe menaxhimit të keq e të politizuar ndër vite, KMDK ka vuajtur nga një imazh negativ në publik. Reflektimi i ndërmarrjes në mediat ka qenë kryesisht negativ, me komunitetet përreth deponive që kanë ngritur vazhdimisht ankesa ndaj ndërmarrjes, të cilat janë adresuar te mediat dhe institucionet përkatëse.

Në vitin 2025, KMDK synon të ndërtojë një identitet të ri korporativ, që do të reflektojë objektivat e ndërmarrjes për të kontribuar në përparimin drejt ekonomisë qarkore. Ky ribrandim do të shoqërohet me një angazhim të shtuar për promovimin e identitetit të ri, duke theksuar kontributin pozitiv të KMDK në komunitet dhe mjedis.

Përmirësimi i dukshëm i gjendjes në deponitë sanitare, i cili ka nisur gjatë vitit 2024, do të vazhdojë dhe intensifikohet në vitet në vijim. Realizimi i hapave gjatë implementimit të Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II-IV do të mundësojë promovim pozitiv të ndërmarrjes.

Objektivat kryesore të marketingut për KMDK Sh.A. janë:

1. Krijimi i një identiteti dhe brendi të ri, modern dhe korporativ për ndërmarrjen;
2. Avancimi i prezencës në internet, përfshirë faqen e internetit dhe platformat e rrjeteve sociale;
3. Promovimi vizual i brendit të ri në deponitë sanitare dhe lokacionet e ndërmarrjes;
4. Përmirësimi i marrëdhënieve me klientët ekzistues;
5. Promovimi i ndërmarrjes për të tërhequr klientë të rinj.

Këto objektiva do të realizohen përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore brenda ndërmarrjes, rekrutimit të stafit të kualifikuar dhe angazhimit të shërbimeve profesionale të konsulencës. Ndërmarrja do të rrisë prezencën pozitive në mediat publike në vend dhe me pjesëmarrje në aktivitete publike. Ndërmarrja do të intensifikojë marketingun online dhe do të vazhdojë përmirësimin e shërbimeve ndaj klientëve, duke njohur dhe përmbushur në mënyrë të vazhdueshme nevojat dhe kërkesat e tyre.

3.2 Marrëdhëniet me publikun

Një kujdes i veçantë do t'i kushtohet marrëdhënieve me publikun. Përgjatë vitit 2024, ndërmarrja ka organizuar takime me komunitetin në vendbanimet pranë deponive dhe ka dëgjuar e adresuar shqetësimet e banorëve të cilët janë ankuar që ankesat e tyre në të kaluarën kanë rënë në vesh të shurdhër. Angazhimi me komunitetin mundëson përmirësimin e imazhit të ndërmarrjes dhe rrënimin e keqkuptimeve dhe paragjykimëve.

Përgjatë viteve të ardhshme, ndërmarrja do të mirëmbajë komunikimin me komunitetin përreth deponive me takime të rregullta informuese me banorët dhe udhëheqësit e komunitetit. Ndërmarrja do të shohë mundësitë për angazhim në të mirë të komunitetit në vendbanimet ku operojnë deponitë.

Ndërmarrja ka përfituar shumë nga bashkëpunimi me ndërmarrjet tjera publike. Përgjatë viteve të ardhshme do të intensifikohet komunikimi dhe bashkëpunimi me ndërmarrjet publike me synim krijimin e formateve standarde të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve me ndërmarrjet tjera.

Kompania ka përmirësuar dukshëm raportin me qeverinë, komunat dhe institucionet tjera publike. Përgjatë viteve të ardhshme ky raport do të intensifikohet dhe përmirësohet edhe më tutje në të mirë të përbashkët.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është qenësor për të përmirësuar pozicionin e ndërmarrjes në shoqëri. Përgjatë viteve të ardhshme do të thellohet bashkëpunimi i ndërmarrjes me OJQ-të dhe do të synohet të formalizohet me marrëveshje bashkëpunimi me përfitime të ndërsjella.

3.3 Analiza SWOT

Tabela 1. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
● Kompania e vetme qendrore për menaxhimin e deponive në vend. ● Traditë e gjatë e shërbimeve të ofruara, afër 17 vite. ● Ofrues i specializuar i shërbimeve të trajtimit të mbeturinave. ● Menaxhment i ri.	● Mungesa e lejeve dhe pelqimeve institucionale. ● Operimi i deponive përtej afatit të paraparë. ● Borxhet e akumuluar. ● Mungesa e burimeve financiare për zëvendësimin aseteve të amortizuara. ● Mungesa e ndërtesës administrative. ● Mungesa e stafit adekuat profesional.
Mundësitë	Rreziqet
● Ndërtimi i kapaciteteve të reja moderne. ● Ndërtimi i shërbimeve të reja. ● Ndërtimi i sistemit të avancuar të menaxhimit të burimeve njerëzore. ● Mundësia e zgjerimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. ● Mundësia e zgjerimit të aktiviteve në trajtimin e mbeturinave. ● Zvogëlimi i shpenzimeve. ● Modernizimi dhe digitalizimi i shërbimeve. ● Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.	● Fundosja e DS Mirash. ● Konteesti eventual për lokacionin e DS të re. ● Aksidentet ekologjike. ● Zvogëlimi i volumit të mbetur për deponim. ● Shfaqja e zjarreve dhe eksplozimet e mundshme në DS. ● Incidentet dhe aksidentet të mundshme për shkak të qasjes së personave të pa autorizuar në DS. ● Ndërhyrjet e jashtme në kompani. ● Tarifa aktuale e ulët aktuale.

Analiza SWOT tregon se kompania ka një pozicion të fortë dhe mundësi për rritje, por duhet të adresojë dobësitë dhe rreziqet për të garantuar qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e saj në të ardhmen. Një strategji e qartë për menaxhimin e lejeve, rritjen e tarifave dhe përmirësimin e burimeve financiare do të jetë e domosdoshme për të përballuar këto sfida.

4. Organizimi dhe menaxhimi

4.1 Struktura e ndërmarrjes

KMDK SH.A. ka strukturën e saj organizative në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përbëhet nga Bordi Drejtorëve si organ mbikëqyrës i emëruar nga Aksionari, e poashtu edhe nga Komisioni i Auditimit i cili përbëhet nga tre anëtarë që janë pjesë e Bordit të Drejtorëve, por që emërohen nga Ministri i ME-së.

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është shoqëri aksionare, përmes Bordit të Drejtorëve i përgjigjet Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) të Ministrisë së Ekonomisë.

Studimi i Fizibilitetit për Programin e Menaxhimit të Ngurta II-IV ka konkluduar që struktura organizative e ndërmarrjes nuk u përshtatet nevojave të ndërmarrjes dhe ka rekomanduar rishikim të ndërmarrjes. Rishikimi i ndërmarrjes planifikohet të ndodhë në pjesën e parë të vitit 2025 me fokus në administratën qendrore kurse rishikimi në pikat operative jashtë ndërmarrjes pritet të ndodhë në vitet e ardhshme.

KMDK SH.A ka këtë strukturë organizative: Bordi emëron tre zyrtarët e lartë (Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar dhe Thesarit si dhe Sekretarin e Kompanisë), kurse Komisioni i Auditimit e emëron Auditorin e Brendshëm.

4.2 Ekipi menaxhues

Kryeshefi Ekzekutiv është pozita më e rëndësishme në ndërmarrje ngase është përgjegjës për menaxhimin e ndërmarrjes, angazhimin e burimeve korporative, me qëllim realizimin e synimeve dhe objektivave strategjike të përcaktuara me Planin e Biznesit dhe për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve.

Zyrtarë të tjerë të lartë dhe të mesëm në ndërmarrje janë:

1. Zyrtari Kryesor Financiar i Thesarit,
2. Sekretari i Korporatës,
3. Zyrtari i Lartë i Auditimit,
4. Drejtorët,
5. Menaxherët e DS dhe ST
6. Udhëheqësit e njësive.

4.3 Struktura organizative

Ndërmarrja planifikon të angazhohet paralelisht në fillimin dhe realizimin e ristrukturimit të ndërmarrjes por në të njëjtën kohë të bëjë edhe rekrutimin e profesionistëve të rinj për pozitat relevante të lira. Në bazë të planifikimit, KMDK Sh.A. do të rekrutojë staf të ri profesional me fokus në rritjen e kapaciteteve për realizimin e projekteve dhe konceptimin e projekteve të reja.

Procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes do të jetë publik dhe transparent, jo-diskriminues dhe në përputhje të plotë me rregullat dhe ligjet në fuqi. Karakteristikë kryesore e këtij procesi do të jetë etika dhe profesionalizmi.

Tabela 2. Numri i të punësuarve dhe struktura gjinore


	Struktura	Numri i punëtorëve
1.	Administrata Qendrore	
1.1	Gra	14
1.2	Burra	15
1.3	Me nevoja të veçanta	1
2.	Operativa - Deponitë Sanitare (teknikët, kontrollorët, sigurimi, mirëmbajtësja)	63
2.1	Gra	4
2.2	Burra	61
2.3	Nevoja të veçanta	1
Numri total i punëtorëve		92

**Struktura gjinore në Operativë është e tillë për shkak të natyrës specifike të punës.*

4.4 Rekrutimi i stafit

Gjatë vitit 2025, bazuar në Rregulloren e Brendshme për Procedurën e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendit të Punës në KMDK, dhe në përputhje me Planin e Biznesit, synojmë të plotësojmë pozitat e lira. Procesi i ristrukturimit të ndërmarrjes do të përcaktojë nevojat e ndërmarrjes për ekspertizë.

Skema organizative aktuale e KMDK Sh.A.*



* Kjo skemë organizative aktuale është përgatitur nga studiimi i fizibilitetit.

4.5 Plani i personelit

KMDK Sh. A. veprimtarinë e saj e zhvillon në tërë territorin e Kosovës. Këtë veprimtari në vitin 2025 do ta kryejë përmes punonjësve në deponitë sanitare dhe STF, të shtrira në të gjitha rajonet e Republikës së Kosovës, me mundësi zgjerimi edhe për 2 – 4 DS, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e integruar të mbeturinave.

Përgjatë vitit 2025, ndërmarrja do të riformatojë në tërësi proceset e personelit duke siguruar rregullativën adekuate. Paralelisht, KMDK Sh.A. do të ndërtojë një sistem ERP për menaxhimin e stafit.

4.6 Plani i trajnimeve

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të ndërmarrjes publike në KMDK Sh.A. janë paraparë edhe trajnime në fusha të ndryshme nga drejtoritë dhe departamentet e caktuara. Në tabelën e paraqitur më poshtë janë specifikuar trajnimet sipas nevojave të drejtorive, duke ngritur kështu kapacitetet e tyre në shërbim të zhvillimit të ndërmarrjes KMDK Sh.A. Lista aktuale e trajnimeve është paraqitur më poshtë por do të modifikohet sipas nevojave të identifikuara përgjat procesit të ristrukturimit të ndërmarrjes.

Qëllimi i këtij plani të trajnimeve është planifikimi, organizimi dhe implementimi i analizës së nevojave të trajnimeve për të punësuarit në KMDK SH.A. Plani i trajnimit është një dokument unik i përfshirjes së të gjitha trajnimeve të planifikuara në baza vjetore përmes së cilët arrihet një pasqyrë mbi fushat e trajnimit, kohëzgjatjen e trajnimit, grupet e synuara dhe hapësirat e zhvillimit të trajnimit.

Plani i trajnimeve paraqet koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të drejtorive në KMDK SH.A., në fushën e trajnimeve, përmes së cilit rritet efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve KMDK-së në përditshmërinë e zbatimit të detyrave zyrtare. Në tabelën e më poshtë janë paraqitur trajnimet e nevojshëm që ka parapara KMDK SH.A. për stafin gjatë vitit 2025.

Tabela 3. Orari i trajnimeve të stafit KMDK Sh.A.

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësve për trajnim	Titulli i programit/kursit të trajnimit dhe rezultatet e pritura	Afati i planifikuar
1. E-Prokurimi	15	-Trajnim për prokurimin publik - Bazik dhe Menaxhimi i kontratave. Me këtë trajnim aftësohet stafi në menaxhimin e kontratave në përputhje me bazën ligjore.	Mars 2025
1.1 E-Prokurimi	15	-Menaxhimi i kontratave përmes e-Prokurimit. Me këtë trajnim aftësohet stafi në menaxhimin e prokurimit përmes platformës e-prokurimi.	Prill 2025
2. Administrata	20	Proceset administrative në ndërmarrjet publike. Aftësohen punonjësit në proceset administrative.	Shtator/Dhjetor 2025
2.1 Administratë dhe Legjislacion	10	Trajnim për etikë dhe kundër korrupsionit. Me këtë trajnim aftësohen punonjësit me të kuptuarit e bazës ligjore sa i përket etikës në punë dhe luftimit të korrupsionit.	Shtator/dhjetor 2025
2.2 Menaxhimi i punëve në Arkivë dhe protokoll	2	-Puna në protokol dhe arkivimi dhe klasifikimi i dokumenteve. Me këtë trajnim aftësohen punonjësit në punën në arkiv dhe protokol sipas bazës ligjore dhe praktikave më të mira.	Shtator/nëntor 2025

3. Operativë, (Siguri dhe shëndet në punë)	60	-Siguri dhe shëndet në punë, dhënia e ndihmës së parë, evakuimi dhe shpëtimi. Me këtë trajnim, aftësohen punonjësit për dhënien e ndihmës së parë, evakuimit dhe shpëtimit.	Shtator/dhjetor 2025
7.1 Operativa	09	Mbrojtje e ambientit. Me këtë trajnim aftësohen punonjësit me kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit.	Shtator/dhjetor 2025
7.2 Operativa, (trajnim për makinistët)	15	Trajtimi dhe kompaktimi i mbeturinave. Me këtë trajnim aftësohen makinistët në përmirësimin e procesit të kompaktimit.	Mars/prill 2025
8. Trajnim për Zyrtarët e Lartë të Ndërmarrjeve Publike	4	-Edukimi i Vazhdueshëm profesional (EVP). Me këtë trajnim, zyrtarët e lartë aftësohen në fusha të ndryshme sa i përket menaxhimit të ndërmarrjeve publike.	Gjatë vitit 2025
9. Financa	3	Trajnim për Quickbooks. Me këtë trajnim, aftësohen punonjësit të operojnë me programin Quickbooks.	Gjatë Q2 2025

4.7 Struktura e të punësuarve dhe kompensimi

Duke marrë parasysh peshën e ndërmarrjes për arritjen e objektivave shtetëror në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave, ndërmarrja synon të jetë kompetitive në tregun e punës për të joshur staf të kualifikuar. Niveli i kompensimit të pagës së personelit të KMDK Sh. A. është gjithëpërfshirës dhe përcaktohet në bazë të vendit të punës, përgatitjes profesionale, aftësive dhe shkathtësive.

4.8 Këshilltarët e jashtëm

Në mënyrë që KMDK SH.A të përmirësojë shërbimet aktuale dhe të implementojnë shërbime të reja inovative, duhet që të angazhojë këshilltarë të jashtëm sipas nevojës.

Këshilltarët e jashtëm duhet të përmbushin të gjitha kualifikimet e parashikuara dhe të kenë përvojë në lëmin e ekspertizës përkatëse. Në këtë mënyrë, KMDK mund të ngritë kapacitetet e brendshme dhe mund të përcjellë trendet më të fundit në industrinë e menaxhimit të integruar të mbeturinave, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e vendit në përputhje me objektivat për ruajtjen e mjedisit. Disa nga shërbimet të cilat kërkojnë angazhim të konsulentëve të jashtëm përfshijnë: përgatitjen e projekteve, ngritjen e kapaciteteve të stafit, anketimin e konsumatorëve dhe përgatitjen e masave për përmirësim të kujdesit ndaj konsumatorëve, hulumtimet e tregut, përgatitjen dhe rishikimin e planit të biznesit, si dhe implementimin e projekteve të ndryshme zhvillimore, të cilat kërkojnë ekspertizë që nuk e posedon KMDK-ja.

4.9 Menaxhimi i burimeve njerëzore

Krahas rristrukturimit organizativ në përputhje me të gjeturat e studimit të fizibilitetit, ndërmarrja jonë synon të ndërtojë një model të avancuar të menaxhimit të burimeve njerëzore të bazuar në tre faza kyçe:

a) Caktimi i Objektivave

- Proces bashkëpunues për vendosjen e objektivave SMART për secilin punonjës.
- Përputhja e objektivave individuale me synimet dhe vlerat organizative.
- Dokumentimi i pajtuar në planin e caktimit të objektivave.

b) Vlerësimi i Performancës

- Feedback i vazhdueshëm gjatë ciklit të performancës.
- Rishikim në mes të ciklit për të vlerësuar progresin.
- Vlerësim në fund të vitit për të vlerësuar arritjet.
- Vlerësimi i performancës për mundësi zhvillimi.

c) Plan Zhvillimi Profesional (trajnimi)

- Analiza e hendekut të shkathtësive dhe identifikimi i fushave për përmirësim.
- Plan zhvillimi profesional individual.
- Përcaktimi i burimeve për zhvillimin e shkathtësive.
- Monitorimi i rregullt i progresit të planit.
- Diskutime për rrugën profesionale për avancim profesional afatgjatë.

Modeli i burimeve njerëzore do të synojë promovimin e rritjes profesionale të punonjësve, përputhjen e qëllimeve dhe ndërtimin e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm, duke u siguruar që punonjësit kanë mbështetjen adekuate për të shkëlqyer në rolet e tyre. Menaxhmenti do të identifikojë nevojat dhe kërkesat për avancim të mëtutjeshëm profesional të stafit sipas natyrës së punës, (si ndryshimi i legjislacionit, zhvillimet teknologjike dhe mekanike etj.).

5. Plani operacional për KMDK 2025-2027

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës ka për detyrë të mbajë operacionet e vazhdueshme në deponitë e vjetra, ndërkohë që avancojnë ndërtimin e qelizave të reja të deponive. Fokusi kryesor i këtij plani operacional është të sigurojë shërbime të efektshme për menaxhimin e mbeturinave, të përmirësojë operacionet e deponive, të optimizojë përdorimin e hapësirës së disponueshme dhe të adresojë sfidat e infrastrukturës. Plani përshkruan aktivitetet kryesore për periudhën 2025-2027 për të arritur këto qëllime.

Objektivat strategjike:

1. Vazhdimi i operacioneve në deponitë e vjetra gjatë ndërtimit të qelizave të reja.
2. Përmirësimi i kompaktimit dhe mbulimit të mbeturinave për të optimizuar hapësirën dhe minimizuar ndikimin negativ në mjedis.
3. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe mirëmbajtjes së deponive.
4. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të ujërave të zeza të deponive.
5. Bashkëpunimi me komunat për mirëmbajtjen e rrugëve drejt deponive.

5.1 Prioritetet operative për vitin 2025:

1. **Vazhdimi i pranimin të mbeturinave dhe operacionet e efektshme në deponitë e vjetra:**
 - Sigurimi i shërbimeve të pandërprera për pranimin dhe menaxhimin e mbeturinave në qelizat e vjetra të deponive.
 - Operimi duke përmirësuar gjendjen drejt standardeve të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit për të zbutur rreziqet e lidhura me teknologjitë e vjetra.
2. **Ndërtimi i qelizave të reja të deponive:**
 - Fillimi i ndërtimit të qelizave të reja të deponive që përmbushin standardet moderne të BE-së për mbrojtjen e mjedisit.

- Koordinimi i afateve të ndërtimit me ekipet operative për të siguruar një kalim të qetë teksa kapaciteti në qelizat e vjetra zvogëlohet.
- 3. **Optimizimi i kompaktimit dhe vëllimit të mbeturinave:**
 - Intensifikimi i kompaktimit të mbeturinave për të siguruar përdorimin optimal të hapësirës në deponitë ekzistuese.
 - Krijimi i monitorimit të rregullt për të siguruar që mbeturinat të kompaktohen në densitetin maksimal të mundshëm, duke kursyer hapësirën e deponive.
- 4. **Përmirësimi i mbulimit të mbeturinave dhe kontrollit mjedisor:**
 - Zbatimi i mbulimit të rregullt të mbeturinave duke përdorur materiale të përshtatshme për të minimizuar erën e keqe, rreziqet e zjarrit dhe mbeturinat e shpërndara nga era.
- 5. **Menaxhimi i ujërave të zeza**
 - Kryerja e një vlerësimi të sistemeve të vjetra të trajtimit të ujërave t.
 - Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme për të përmirësuar mbledhjen dhe menaxhimin e ujërave të zeza, si pompa shtesë, përmirësimi i kullimit dhe rezervuarë të përkohshëm.
- 6. **Mirëmbajtja e infrastrukturës dhe rrugëve:**
 - Bashkëpunimi me komunat për të mirëmbajtur rrugët e qasjes drejt dhe nga deponitë, duke siguruar transport të qetë dhe duke reduktuar ndikimin në komunitetet përreth.
 - Caktimi i një ekipi të dedikuar për të monitoruar dhe kryer riparimet e nevojshme të rrugëve.

Për të siguruar realizimin e këtyre objektivave, KMDK ka paraparë angazhimin e makinerisë shtesë nga operatorë ekonomikë ose ndërmarrjet simotra publike.

5.2 Prioritetet operative për vitin 2026:

1. **Përfundimi dhe hapja e qelizave të reja të deponive:**
 - Përfundimi i ndërtimit të qelizave të reja të deponive në përputhje me standardet e BE-së dhe fillimi i operacioneve.
 - Tërheqja graduale nga operacionet në qelizat e vjetra të deponive dhe transferimi i operacioneve në qelizat e reja.
2. **Sigurimi i makinerisë së rëndë**
 - Sjellja dhe operacionalizimi i makinerisë së rëndë të re në të gjitha deponitë.
 - Trajnimi i stafit për operim optimal me makineri.
3. **Zgjidhje të përmirësuara për menaxhimin e ujërave të zeza të deponive:**
 - Fillimi i zbatimit të teknologjive të përmirësuara për trajtimin e ujërave të zeza për qelizat e reja.
 - Vazhdimi me zgjidhjet afatshkurtra për menaxhimin e ujërave të zeza në qelizat e vjetra ndërkohë që punohet për përmirësime të përhershme.
4. **Kompaktimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i mbeturinave në qelizat e reja:**
 - Avancimi drejt praktikave më të mira për kompaktimin e mbeturinave, duke siguruar përdorimin maksimal të volumit të deponisë dhe reduktimin e kostovë operative.
 - Përmirësimi i sistemeve të monitorimit për ndjekjen në kohë reale të niveleve të kompaktimit dhe kapacitetit të deponisë.
5. **Përmirësime të infrastrukturës:**

- o Investimi në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të deponive, duke përfshirë rrugët brenda deponive, pistat e zbrazjes, sistemet e kullimit dhe zonat e trajtimit të mbeturinave.
 - o Vazhdohet monitorimi dhe mirëmbajtja e rrugëve hyrëse jashtë deponive në bashkëpunim me komunat.
- 6. Përputhshmëria mjedisore dhe angazhimi me komunitetin:**
- o Forcimi i sistemeve të monitorimit mjedisor për të siguruar përputhshmëri me rregulloret kombëtare dhe ato të BE-së.
 - o Angazhimi me komunitetet lokale për të përmirësuar marrëdhëniet dhe adresuar çdo shqetësim në lidhje me operacionet e deponive dhe menaxhimin e mbeturinave.

5.3 Prioritetet operative për vitin 2027:

1. **Optimizimi i operacioneve të qelizave të reja të deponive:**
 - o Kalimi i të gjitha operacioneve në qelizat e reja të deponive, me fokus në maksimizimin e efikasitetit dhe përbushjen e standardeve mjedisore.
 - o Kryerja e një rishikimi të performancës së qelizave të reja të deponive për të siguruar që ato po përbushin kapacitetin dhe objektivat mjedisore.
2. **Mirëmbajtja dhe përmirësimet e vazhdueshme të infrastrukturës:**
 - o Vazhdohet me mirëmbajtjen dhe përmirësimet e rregullta të infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të deponive.
 - o Bashkëpunimi i ngushtë me komunat për të siguruar që të gjitha rrugët hyrëse të jenë në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

5.4 Plani investiv i ndërmarrjes

Plani investiv i KMDK-së përbëhet nga katër komponente kryesore:

1. Investimet nepërmjet Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II-IV
2. Investimi në shërbimet e reja
3. Investimet në mirëmbajtjen e deponive aktuale
4. Investimi në infrastrukturën administrative të ndërmarrjes

5.4.1 Plani operacional i KMDK për fazat e programit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta II-IV (2024-2028)

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë po implementon një projekt të madh të menaxhimit të mbeturinave, i cili përfshin tre faza të ndërlidhura që shtrihen nga përgatitja e dizajnit, përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe tenderimi dhe implementimi. Ky projekt i paraparë në shumën prej 53 milionë euro, synon të modernizojë infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave në vend, duke përfshirë ndërtimin e qelizave të reja të deponive, përmirësimin e teknologjisë së menaxhimit të gazit dhe mbetjeve të lëngshme, si dhe përputhjen me standardet më të larta mjedisore dhe sociale. Angazhimi i vazhdueshëm i KMDK-së për përmirësimin e kapaciteteve infrastrukturore të deponive dhe implementimi i standardeve mjedisore e sociale është në përputhje me objektivat strategjike të Kosovës për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave. Projekti është dukur-u realizuar me mbështetje teknike të jashtme të financuar nga KfW/BE.

- a) **Faza 1: Përgatitja e dizajnit dhe dokumenteve tenderuese**

Faza e parë e projektit fokusohet në përgatitjen e dizajnit të detajuar dhe dokumenteve të tenderit për ndërtimin dhe modernizimin e deponive të reja dhe ekzistuese. Ky kryhet gjatë vitit 2024 ku një fazë fillestare të rishikimit të dokumenteve teknike dhe mjedisore ekzistuese është kryer në pjesën e parë të vitit 2024. Një nga hapat kryesorë ishte organizimi i takimit fillestar dhe rishikimi i dokumentacionit të disponueshëm për të përcaktuar nevojat dhe mundësitë për përmirësim. Raporti i fazës fillestare ka dokumenton gjetjet dhe ka çaktuar drejtimin për veprimet e mëtejshme. Gjatë kësaj faze janë evidentuar një numër ndryshimesh të nevojshme nga studimi i fizibilitetit.

Një tjetër fokus i rëndësishëm i kësaj faze është përgatitja e Vlerësimeve të Ndikimit Mjedisor (VNM) për deponitë kryesore në Prizren, Gjiçan, Pejë, Podujevë, Istog, Prishtinë/Lipjan dhe Ferizaj. Këto VNM janë thelbësore për sigurimin e përputhshmërisë me standardet shtetërore dhe ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Përderisa dokumentet janë duke përgatitur dhe miratuar, zhvillohet faza e përgatitjes së dizajnit të detajuar për deponitë. KMDK do të përgatisë dizajne të detajuara për qelizat e reja të deponive dhe sistemet mbështetëse, duke përfshirë edhe sisteme për menaxhimin e gazit dhe adresimin e nevojave emergjente në deponinë e Mirashit. Një pjesë e rëndësishme e dizajnit përfshin përfshirjen e standardeve për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë Sociale (MSHSS) që sigurojnë menaxhim të qëndrueshëm dhe përgjegjës të mbeturinave.

Përgatitja e dokumenteve të tenderit dhe të parakualifikimit përzgjedh kontraktorët dhe operatorit ekonomik që do të realizojnë këto projekte të infrastrukturës. Dokumentet përfshijnë edhe matricën të vlerësimit për përzgjedhjen e ofertuesve, duke përfshirë kritere për përputhshmërinë me standardet MSHSS. Në këtë fazë është në proces edhe shpronësimi i parcelave ku kryen veprimtarinë e vet ndërmarrja.

b) Faza 2: Asistenca gjatë tenderimit (2025-2028)

Faza e dytë është thelbësore për zbatimin e procesit të tenderimit. KMDK do të pranojë asistencë gjatë të gjithë këtij procesi, duke përfshirë përgatitjen e dokumenteve të parakualifikimit, publikimin e tyre dhe sqarimet e nevojshme për ofertuesit potenciale.

Hapi i parë është procesi i parakualifikimit, ku dokumentet e nevojshme publikohen dhe ofrohen sqarime për ofertuesit. Pasi ofertuesit të dorëzojnë dokumentet e tyre, KMDK mbështet në vlerësimin dhe përzgjedhjen e atyre që plotësojnë kriteret e kërkuara.

Pas përfundimit të fazës së parakualifikimit, kalohet në procesin e tenderimit. Gjatë këtij procesi, dokumentet e tenderit përgatiten dhe publikohen, duke përfshirë sqarime për ofertuesit. Një fokus i veçantë vendoset në përputhshmërinë me kriteret MSHSS, duke siguruar që të gjitha ofertat të përmbushin standardet e kërkuara për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë.

Pas dorëzimit të ofertave, KMDK do të pranojë mbështetje në vlerësimin e ofertave dhe negociimin e kontratave në përputhje me rregullativën. Gjatë këtij hapi, kontrollëhet përputhshmëria e ofertave me kriteret MSHSS dhe zhvillohen negociatat përfundimtare për dhënien e kontratave.

c) Faza 3: Implementimi dhe zbatimi i projekteve (2026-2028)

Pas përfundimit të procesit të tenderimit dhe dhënies së kontratave, faza e tretë përqendrohet në implementimin e projekteve. Ndërtimi i qelizave të reja të deponive në Pejë, Prizren, Gjiilan dhe lokacionet e tjera kryesore do të nisë. Paralelisht me programin, KMDK do të zhvillojë hapa drejt adresimin të emergjencave në deponinë e Mirashit, me fokus të veçantë në menaxhimin e gazit dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit në zonën përreth.

KMDK do të monitorojë nga afër përparimin e projekteve për të siguruar që të gjitha punimet të përfundojnë brenda afateve të paracaktuara dhe në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale. Pjesë e rëndësishme e këtij monitorimi do të jetë edhe përfshirja e palëve të interesuara dhe angazhimi me komunitetet përreth për të minimizuar çdo ndikim negativ dhe për të siguruar përfitime afatgjata për to.

Në përfundim të projekteve, KMDK do të sigurojë që të gjitha qelizat e reja dhe infrastrukturat mbështetëse të jenë në funksion të plotë dhe të menaxhohen sipas standardeve të pranuara ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave.

d) Përputhshmëria me standardet mjedisore dhe sociale

Gjatë të gjithë procesit, një prioritet i lartë për KMDK është përputhshmëria me standardet mjedisore dhe sociale. Këto përfshijnë angazhimin e vazhdueshëm me palët e interesuara, përgatitjen e planeve për menaxhimin e mbeturinave dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë për të gjithë të përfshirët në projekte. Përputhshmëria me kriteret MSHSS është thelbësore për suksesin afatgjatë të këtyre projekteve dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet përreth deponive.

e) Sfidat

KMDK përballët me një numër të madh sfidash në realizimin e programit. Pikë së pari janë sfidat financiare ku një pjesë e fondeve në kohën e shkrimit të këtij Plani të Biznesit janë të ngrira nga BE për shkak të masave. Ende nuk është tërësisht e qartë si do të sigurohen fondet participuese nga Republika e Kosovës si dhe fondet shtesë që nevojiten për shkak të shtimit të kostos së projektit gjatë fazës fillestare për shkak të inflacionit dhe ndryshimeve të parapara. Programi përballët me sfida administrative posqërisht nga mungesa e bashkëpunimit prej Komunës së Lipjanit.

5.4.2 Investimi në shërbimet e reja

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës synon të vazhdojë investimet në shërbime të reja që përputhen me objektivat strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke përmirësuar kapacitetet për menaxhimin e mbeturinave dhe për të rritur riciklimin. Një nga projektet kryesore është ndërtimi i një pike ndarëse të mbeturinave në Deponinë e Gjilanit në Velekincë. Ky investim do të kontribuojë në ndarjen më efektive të mbeturinave dhe përmirësimin e kapaciteteve të riciklimit.

Procesi për realizimin e këtij investimi fillon me identifikimin e nevojave për shërbime të reja që përputhen me prioritetet kombëtare dhe me objektivat për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave. Ndërtimi i pikës ndarëse në Velekincë është një nga projektet e para që do të iniciohet, me qëllim që të përmirësohet procesi i ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave në këtë rajon.

Pas identifikimit të projektit, krijohet një ekip i dedikuar për menaxhimin e këtij investimi. Ky ekip përbëhet nga ekspertë të menaxhimit të mbeturinave, inxhinierë dhe specialistë financiarë, të cilët bashkëpunojnë ngushtë me konsulentë të jashtëm për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe dizajnit të projektit. Studimi i fizibilitetit analizon nevojat lokale për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave, teknologjitë më të fundit për ndarjen e mbeturinave dhe përfitimet ekonomike dhe mjedisore të këtij investimi.

Një aspekt kyç i këtij procesi është sigurimi i burimeve të financimit. KMDK do të eksplorojë burime të ndryshme financimi, përfshirë kapitalin e brendshëm, fonde qeveritare dhe grante nga donatorët ndërkombëtarë që mbështesin projekte të qëndrueshmërisë. Një pjesë e fondeve për këtë projekt tashmë janë siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Identifikimi i këtyre burimeve do të sigurojë që projekti të ketë mbështetjen e nevojshme financiare për të përfunduar me sukses.

Pasi të përfundojë studimi i fizibilitetit dhe të jenë siguruar burimet e financimit, fillon përgatitja e dokumenteve të tenderit për përzgjedhjen e kompanisë që do të ndërtojë pikën ndarëse. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë specifikimet teknike të projektit dhe kriteret për përputhshmëri me standardet mjedisore dhe sociale, duke siguruar që projekti të jetë në përputhje me kriteret ESHS (Mjedis, Shëndet, Siguri dhe Sociale).

Ndërtimi i pikës ndarëse do të fillojë menjëherë pasi të përfundojë procesi i tenderimit. Kompania ndërtuese do të monitorohet nga një ekip i dedikuar për të siguruar që punimet zhvillohen sipas planit dhe në përputhje me standardet e përcaktuara. Gjatë ndërtimit, do të zbatohen masa për minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale, duke siguruar që projekti të kontribuojë në përmirësimin e kushteve mjedisore në komunitetin përreth.

Pas përfundimit të ndërtimit, pika ndarëse e mbeturinave do të inspektohet për të siguruar që përmbush të gjitha specifikimet teknike. Me përfundimin e inspektimeve dhe sigurimin e të gjitha lejeve të nevojshme, objekti do të dorëzohet për të filluar operimet. Ky projekt do të shërbejë si një model për investime të ardhshme në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, duke kontribuar në qëndrueshmërinë mjedisore dhe rritjen e kapaciteteve të riciklimit në Kosovë.

Ky plan për investimet në shërbimet e reja për KMDK përfshin një qasje të strukturuar që nga identifikimi i nevojave, përgatitja e fizibilitetit, sigurimi i financimit dhe ndërtimi i infrastrukturës, me qëllim që të përmbushen objektivat strategjike të menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe kalimit drejt një ekonomie qarkore.

Ngjashëm do të operohet edhe në projektet tjera potenciale.

5.4.3 Plani i investimet në mirëmbajtjen e deponive aktuale

Plani i investimeve për mirëmbajtjen e operacioneve në deponitë e vjetra të KMDK përfshin sigurimin e burimeve për mbulimin e mbeturinave me dhe, si dhe blerjen e zhavorit dhe sigurimin e materialeve të inerteve për mirëmbajtjen e infrastrukturës së brendshme të deponive. KMDK ka ndërprerë praktikën e blerjes së shtrenjtë të dheut. Ky plan synon të sigurojë që deponitë e vjetra të vazhdojnë të funksionojnë në përputhje me standardet mjedisore, duke minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe përmirësuar infrastrukturën e brendshme për të rritur sigurinë dhe eficiencën operacionale. Për realizimin e këtyre investimeve KMDK do të bazohet në fonde të brendshme. Për

më shumë, KMDK planifikon implementimin e masave emergjente në Deponinë e Mirashit për të adresuar rreziqet nga gasi dhe për të minimizuar ndikimin nga ujrat e zeza.

5.4.4 Investimi në infrastrukturën administrative të ndërmarrjes

Në vitin 2025, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës synon të fillojë ndërtimin e një ndërtese të përhershme administrative, që do të zëvendësojë ambientet aktuale me qira. Ndërtimi i një ndërtese të përhershme është një zgjidhje afatgjatë dhe me kosto efektive, e cila do të mbështesë rritjen e operacioneve të kompanisë dhe do të ofrojë hapësirat e nevojshme për funksionet administrative të saj.

Faza e parë e këtij plani do të fillojë me planifikimin paraprak nga janari deri në qershor 2025. Fillimisht, KMDK do të kryejë një vlerësim të detajuar të nevojave aktuale dhe të ardhshme të hapësirës, duke përfshirë numrin e punonjësve, madhësinë e departamenteve, nevojat për sallat takimesh, hapësirat për parking dhe ruajtjen e materialeve. Pas këtij vlerësimi, kompania do të angazhojë një konsulent për dizajn që të hartojë një koncept që përputhet me operacionet dhe planet për zgjerim të kompanisë, duke siguruar gjithashtu që ndërtesa të përmbushë standardet moderne të qëndrueshmërisë dhe efikasitetit energjetik. Po ashtu, në këtë fazë do të zgjidhet vendndodhja e re e ndërtesës, duke u marrë në konsideratë afërsia me lokacionet operative dhe infrastrukturën ekzistuese, si dhe pajtueshmëria me ligjet për përdorimin e tokës.

Pasi të jenë përgatitur planet fillestare, KMDK do të zhvillojë një buxhet të detajuar për ndërtimin, i cili do të përfshijë sigurimin e tokës, dizajnin arkitekturor, lejet dhe kostot e ndërtimit. Kompania do të eksplorojë opsionet e financimit për këtë projekt, duke përfshirë fonde të brendshme, mbështetje nga qeveria ose kredi bankare. Në fund të kësaj faze, kompania do të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme ligjore dhe rregullative për ndërtimin e ndërtesës.

Nga korriku deri në shtator 2025, plani do të kalojë në fazën e dizajnit të detajuar dhe prokurimit. KMDK do të bashkëpunojë me një firmë arkitekturore dhe inxhinierike për të zhvilluar një plan të detajuar arkitekturor, duke përfshirë dizajnin strukturor, elektrik, të ventilimit dhe të ujit. Dizajni duhet të jetë në përputhje me kodet e ndërtimit dhe të integrojë praktikën e qëndrueshme. Pas përfundimit të dizajnit, do të bëhet përlllogaritja e kostove të ndërtimit dhe do të zhvillohet një afat kohor i detajuar për secilën fazë të ndërtimit, duke planifikuar përfundimin e projektit në mes të vitit 2026.

Në këtë fazë, KMDK do të publikojë tenderin për të përzgjedhur kompaninë ndërtuese që do të realizojë projektin. Tenderi do të përfshijë dokumente që specifikojnë qartë fushën e projektit, materialet e kërkuara dhe standardet e nevojshme për përputhshmëri me kriteret për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë sociale. Pas pranimit të ofertave, KMDK do të bëjë vlerësimin e tyre dhe do të zgjedhë ofertuesin më të përshtatshëm bazuar në përvojën e tij, kostot dhe aftësinë për të përmbushur afatet kohore.

Nga tetori 2025 deri në mars 2026, projekti do të kalojë në fazën e ndërtimit. Gjatë kësaj faze, kompania do të angazhojë një menaxher projekti që do të mbikëqyrë procesin e ndërtimit për të siguruar që gjithçka të zhvillohet sipas planit dhe në përputhje me specifikimet e projektit. Vizitat e rregullta në vendin e ndërtimit do të sigurojnë që cilësia e punës është në nivelin e kërkuar dhe që çdo problem të adresohet menjëherë.

Po ashtu, gjatë procesit të ndërtimit, KMDK do të zbatojë një plan të menaxhimit të mjedisit dhe sigurisë për të siguruar që ndërtimi të jetë në përputhje me standardet ESHS. Kompania do të vazhdojë të informojë komunitetin përreth mbi progresin e projektit dhe do të angazhohet për të minimizuar ndikimet negative që mund të lidhen me ndërtimin.

6. Menaxhimi i riskut (Kufizimet dhe Rreziqet)

Menaxhmenti i KMDK Sh.A. parashikon që në të ardhmen do të përballet me sfida dhe rreziqe, si dhe mundësi për zhvillim. Në këtë kontekst, janë identifikuar disa faktorë që mund të ndikojnë në procesin e menaxhimit dhe realizimit të objektivave të ndërmarrjes. Gjatë hartimit të këtij Plani të Biznesit, KMDK i ka kushtuar vëmendje të veçantë kufizimeve dhe rreziqeve që mund të ndikojnë në arritjen e synimeve dhe objektivave të planifikuara. Këto kufizime dhe rreziqe mund të jenë si rezultat i zhvillimeve dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë e kompanisë.

6.1.1 Paqartësitë rreth përcaktimit të lokacionit të deponisë qendër

Një nga sfidat më të mëdha për KMDK-në lidhet me paqartësitë rreth përfundimit të procesit për caktimin e lokacionit të ri për deponinë sanitare qendër. Ky proces ka ndikime të rëndësishme operacionale dhe financiare për ndërmarrjen, duke krijuar pasiguri në lidhje me realizimin e projekteve investuese dhe përmbushjen e objektivave afatgjata. Aktualisht, ky proces është në zhvillim e sipër në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale.

6.1.2 Mosndërtimi i sistemit dhe metodologjisë së përcaktimit të tarifës

Një tjetër rrezik i rëndësishëm është mungesa e një baze rregullative adekuate për përcaktimin e metodologjisë dhe autoritetit të pavarur për vlerësimin periodik të tarifave hyrëse për shërbimet. Tarifa aktuale nuk reflekton kostot reale të trajtimit të mbeturinave, dhe mungesa e një metodologjie të qartë për vlerësimin e tarifave mund të rrezikojë stabilitetin financiar të kompanisë. Ndërtimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe përcaktimi i një autoriteti të pavarur rregullator për të përcaktuar tarifën do të ndihmojë KMDK të mbulojë shpenzimet operative dhe të realizojë projekte investuese të nevojshme.

6.1.3 Rreziqet në tranzicion

Deponitë aktuale operojnë përtej jetëgjatësisë së tyre të planifikuar, gjë që paraqet sfida të mëdha për përmbushjen e standardeve europiane të menaxhimit të mbeturinave. Ndërkohë që po realizohen investime kapitale me mbështetjen e KfW-së, BE-së dhe Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e deponive të reja, procesi i tranzicionit përfshin rreziqe të konsiderueshme, të tilla si fatkeqësitë natyrore, rreziku i fundosjes së deponisë në Mirash, eksplodimet potenciale, zjarret dhe rrëshqitjet e mbeturinave, si dhe rrjedhjet e ujërave të zeza. KMDK ka adresuar këto rreziqe përmes angazhimit të institucioneve përgjegjëse dhe implementimit të masave të nevojshme.

6.1.4 Rreziku financiar

KMDK përballet me rreziqe financiare që lidhen kryesisht me mospagesën e borxheve nga klientët dhe mungesën e fondeve të siguruar nga Republika e Kosovës për pjesëmarrjen në Programin për Mbeturinat e Ngurta II-IV. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është amortizimi i makinerisë së

kompanisë, e cila është e vjetruar dhe vë në rrezik aftësinë e KMDK për të përmbushur detyrat e veta operationale gjatë procesit të tranzicionit.

6.1.5 Deponitë ilegale

Prania e deponive ilegale përbën një sfidë të rëndësishme që mund të ndikojë në sasinë e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare, duke ulur të ardhurat e planifikuara dhe duke shkaktuar pasoja të paparashikueshme mjedisore.

6.2.1 Faktorët e brendshëm (Negativ)

Ndërmarrja përballët me disa faktorë të brendshëm negativë që kufizojnë potencialin e saj për zhvillim. Kultura korporative e krijuar nga menaxhimi i gjatë joprofesional kërkon ndryshime të thella. Teknologjia e vjetruar, struktura e tejkaluar organizative, mungesa e kapaciteteve profesionale, lidhjet nepotike të stafit i cili është edhe i shtyrë në moshë, si dhe mungesa e mjeteve të nevojshme për punë, përbëjnë pengesa të mëdha për zhvillimin e kompanisë. Një menaxhim efikas dhe i strukturuar, së bashku me reforma në administratë dhe infrastrukturë, do të ndihmojnë në tejkalimin e këtyre sfidave.

6.2.2 Faktorët e brendshëm (Pozitiv)

Ndërmarrja gjithashtu ka disa faktorë të brendshëm pozitivë, duke përfshirë pozicionimin e saj të qartë si ndërmarrja qendrore për menaxhimin e mbeturinave në nivel nacional, përvojën e gjatë në këtë sektor, dhe shtrirjen e saj gjeografike në tërë territorin e Kosovës.

6.2.3 Faktorët e jashtëm

Faktorët e jashtëm përbëjnë një tjetër burim rreziku për KMDK, kryesisht të lidhur me zhvillimet politike dhe ekonomike jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të kompanisë. Paqartësitë lidhur me pozicionimin e shërbimeve të reja mes KMDK-së, komunave dhe ndërmarrjeve të tjera të mbeturinave, niveli i ulët i vetëdijes politike për investimet në ekonominë qarkore, dhe konkurrenca ilegale janë sfida të vazhdueshme që kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme për të forcuar performancën e ndërmarrjes.

6.3 Risku për burime njerëzore

Veprimtaria e KMDK kërkon staf me profile të ndryshme dhe kompetenca të specializuara, veçanërisht në fushën e infrastrukturës së deponive sanitare. Mungesa e stafit të kualifikuar apo mosplanifikimi i saktë i nevojave për burime njerëzore mund të krijojnë rreziqe të rëndësishme për funksionimin efikas të ndërmarrjes. Për të adresuar këto sfida, gjatë procesit të ristrukturimit do të ketë fokus të madh në planifikimin me kujdes për nevojat për burime njerëzore, me qëllim të sigurimit të funksionimit të pandërprerë të ndërmarrjes dhe përmbushjes së detyrave operationale si dhe rritjes së synuar të ndërmarrjes.

Për të menaxhuar këto rreziqe, KMDK do të ndjekë një qasje të strukturuar që përfshin:

- Përmirësimin e sistemit të vlerësimit të performancës së punonjësve për të rritur efikasitetin dhe përkushtimin;

- Ristrukturimin, harmonizimin dhe nivelizimin e pozitave dhe koeficientëve të pagave për të siguruar një sistem të drejtë dhe transparent;
- Zbatimin e reformave në administratë dhe përmirësimin e infrastrukturës ligjore për të krijuar një mjedis pune më efektiv dhe të qëndrueshëm;
- Ofrimin e mundësive të ndryshme për edukim dhe trajnime profesionale për të rritur kompetencat e stafit;
- Mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të stafit;
- Praktikimin e qeverisjes së mirë dhe transparente për të siguruar që çdo vendim të jetë në përputhje me standardet më të larta të menaxhimit;
- Promovimin e diversitetit dhe përfshirjes brenda ndërmarrjes për të krijuar një ambient pune më të larmishëm dhe të barabartë.

Këto masa do të sigurojnë që KMDK të operojë në mënyrë efektive dhe të zhvillojë nivelin e lartë të kompetencave profesionale, duke minimizuar rreziqet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore. Në këtë mënyrë, ndërmarrja do të ketë një bazë solide për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme.

6.4 Risku ligjor

Risku ligjor mund të shfaqet si pasojë e padive të jashtme ose nga mosrespektimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme nga punonjësit. Për të minimizuar këto rreziqe, KMDK do të rrisë kapacitetet e saj profesionale juridike duke krijuar një departament të dedikuar ligjor, të pajisur me ekspertizën e nevojshme për të adresuar sfidat ligjore. Gjithashtu, do të sigurohen shërbimet e këshilltarëve ligjorë të jashtëm, të cilët do të ofrojnë këshilla dhe mbështetje profesionale për zgjidhjen e çështjeve ligjore.

Një qasje proaktive për të parandaluar këto rreziqe do të përfshijë trajnimin e rregullt të punonjësve për respektimin e procedurave dhe rregulloreve të brendshme. Po ashtu, do të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm i përputhshmërisë në punë për të identifikuar dhe adresuar çdo problem përpara se të eskalojë në një çështje ligjore. Kjo qasje gjithëpërfshirëse do të ndihmojë në reduktimin e mundësive për çështje gjyqësore dhe do të mbrojë interesat e kompanisë në mënyrë efektive.

6.5 Risku financiar

Menaxhmenti i KMDK Sh.A. i kushton një vëmendje të veçantë riskut financiar, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në mosrealizimin e të hyrave të planifikuara. Kjo mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në përmbushjen e obligimeve operative dhe kontraktuale të përfshira në Planin e Biznesit 2025-2027. Një ndër risqet kryesore është realizimi i të hyrave nga kontratat me klientët për shërbimet e planifikuara.

Në vitin e fundit, KMDK ka pasur përmirësime të ndjeshme financiare, falë rritjes së të hyrave, reduktimit të shpenzimeve joracionale dhe mbledhjes së suksesshme të borxheve. Megjithatë, për të minimizuar më tej riskun financiar, është e nevojshme që të intensifikohen aktivitetet në këto fusha, duke përfshirë përmirësimin e menaxhimit të borxheve dhe rritjen e efikasitetit në operacione. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një qëndrueshmërie financiare afatgjatë dhe përmbushjen e detyrimeve të ndërmarrjes.

7. Plani financiar

Në përpjekje për të përmirësuar efektivitetin operacional dhe për të reduktuar shpenzimet e panevojshme, Kompania e Menaxhimit të Deponive në Kosovë po zbaton disa masa kyçe. Këto përpjekje janë të dizajnuara për të racionalizuar shpenzimet duke shqyrtuar me kujdes të gjitha kostot dhe duke identifikuar fushat ku mund të arrihen efikasitete pa komprometuar cilësinë e shërbimeve ose integritetin operacional.

Plani financiar i kompanisë, i cili përfshin periudhën nga viti 2025 deri në vitin 2027, thekson një qasje strategjike në menaxhimin e kostove duke optimizuar proceset e brendshme dhe eliminuar shpenzimet e tepërta. Nismat kryesore përfshijnë optimizimin e përdorimit të burimeve, reduktimin e shpenzimeve në operacionet administrative dhe rishikimin e procedurave të prokurimit dhe operimit për të siguruar që çdo euro e shpenzuar të kontribuojë në objektivat kryesore operationale.

Qëllimi kryesor i KMDK-së është të harmonizojë strukturat e saj të kostos me praktikatat moderne të menaxhimit të mbeturinave, të reduktojë gjurmën e saj mjedisore dhe të sigurojë qëndrueshmëri afatgjatë ndërsa kalon drejt një ekonomie rrethore. Përmes këtij menaxhimi të kujdesshëm financiar, kompania synon të arrijë kthime më të larta mbi investimet dhe të sigurojë që fondet publike të përdoren në mënyrë efikase, duke forcuar angazhimin e saj për transparencë dhe përgjegjësi.

7.1 Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025-2027

Plani i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2025-2027 ofron një pasqyrë të qartë të burimeve financiare dhe shpenzimeve operative të KMDK-së për tre vitet e ardhshme. Në këtë periudhë, të ardhurat kryesore priten të vijnë nga aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, të ndara ndërmjet amvisërive dhe klientëve privatë, përfshirë të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuar. Të ardhurat totale operative parashikohet të rriten nga 3,762,848.29 euro në vitin 2025 në 4,743,863.62 euro në vitin 2027, duke reflektuar përmirësime të vazhdueshme në ofrimin e shërbimeve dhe efikasitetin operativ. Plani financiar për periudhën 2025-2027 synon të mbajë një ekuilibër të kujdesshëm midis rritjes së të ardhurave dhe kontrollit të shpenzimeve, duke përmirësuar qëndrueshmërinë financiare dhe operationale të KMDK-së në një periudhë afatmesme dhe duke siguruar fonde për investimet kapitale.

Shpenzimet kryesore do të përqendrohen në pagat e stafit, mirëmbajtjen e makinerisë së rëndë, furnizimin me derivate dhe mirëmbajtjen e automjeteve. Këto shpenzime parashikohen të rriten gradualisht, me një vlerë vjetore nga 2,336,295.42 euro në vitin 2025 në 2,409,410.97 euro në vitin 2027, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesave operationale dhe inflacionit të pritshëm në çmimet e burimeve.

Fitimi operativ para zhvlerësimit është parashikuar të arrijë në 1,511,341.58 euro në vitin 2025, dhe të rritet në 2,409,410.97 euro deri në vitin 2027. Kjo rritje reflekton përpjekjet e kompanisë për të përmirësuar efikasitetin në menaxhimin e shpenzimeve dhe maksimizimin e të ardhurave me synim primar sigurimin e fondeve investive.

Tabela 4. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitet 2025-2027

Të hyrat dhe shpenzimet për vitet 2025-2027

Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2024	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2026	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2027
Spektori I	I - TË HYRAT	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)	Euro (€)
A	1. Të hyrat nga amvisëritë - KRM-të	2.991.743.11	3.060.597 €	3.458.475.00 €	3.908.076.00 €
	2. Të hyrat nga amvisëritë - op. privatë	359.166.71	445.526 €	503.444.82 €	568.892.00 €
	3. Të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuar - KRM-të	108.192.73	96.686.39 €	98.620.12 €	100.592.50 €
	4. Të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuar - op. privatë	83.887.71	155.038.17 €	158.138.93 €	161.301.70 €
	Totali i të hyrave nga aktivitetet kryesore (1+2+3+4)	3.542.990.27	3.757.848.29 €	4.218.678.87 €	4.738.863.62 €
B	5. Të hyrat tjera operative	12.000.00	5.000.00 €	5.000.00 €	5.000.00 €
C	Totali i të hyrave operative (1+2+3+4+5)	3.554.990.27	3.762.848.29 €	4.223.678.87 €	4.743.863.62 €
	6. Të hyrat nga interesi	-	39.031.42 €	39.092.08 €	39.092.08 €
	7. Të hyrat e jashëtzakonshme	-	8.500.00 €	0.00 €	0.00 €
	8. Të hyrat nga grantet (pa përfshirë të hyrat nga Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II-IV)	-	34.757.30 €	34.757.30 €	34.757.30 €
	9. Të hyrat e pritura nga procedurat gjyqësore dhe përmbarimore	257.427.00	2.500.00 €	0.00 €	0.00 €
Ç	Totali i të hyrave tjera (6+7+8+9)	257.427.00	84.788.72 €	73.849.38 €	73.849.38 €
II-SHPENZIMET	Totali i të hyrave (Sekt. A+B+C)	3.812.417.27	3.847.637.01 €	4.297.528.25 €	4.817.713.01 €
D	10. Pagat bazë*	723.941.73	831.871.66 €	831.871.66 €	831.871.66 €
	11. Përvoja e punës sipas koeficientit 0.05% për vit pune	46.055.00	56.865.00 €	56.865.00 €	56.865.00 €
	12. Shujtat	99.792.00	104.832.00 €	104.832.00 €	104.832.00 €
	13. Kompensimet tjera (orët jashtë orarit, pagat jubileare, kompensimi për pensionim, kontratat specifike, praktikat etj.)	52.184.00	54.903.53 €	54.903.53 €	54.903.53 €
	14. Pagat jubileare	-	2.530.00 €	2.530.00 €	2.530.00 €
	15. Kontributet shëndetësore - punëdhënësi	25.337.96	27.810.00 €	27.810.00 €	27.810.00 €
	16. Pagat dhe kontributet për BD	33.264.00	33.264.00 €	33.264.00 €	33.264.00 €
	17. Kontributet pensionale 5% nga punëdhënësi	46.098.64	54.948.61 €	54.948.61 €	54.948.61 €
	18. Shërbimi D.D.D	75.000.00	20.000.00 €	20.400.00 €	20.808.00 €
	19. Furnizimi me dru për ngrohje	7.500.00	7.500.00 €	7.650.00 €	7.803.00 €
	20. Angazhimi i operatorit për trajtimin e ujërave të zeza në kolektor të STF	17.500.00	17.500.00 €	17.850.00 €	18.207.00 €
	21. Angazhimi i makinerisë për shtyerje të mbeturinave, trajtim të mbeturinave, rregullim të skarpave në formë piramide për rritjen e jetëgjatësisë të deponive	50.000.00	100.000.00 €	102.000.00 €	104.040.00 €

	22. Investimi për pompa nëpër DS, dhe instalimeve elektrike në panele, sistemeve riqarkulluese të ujërave	18,000.00	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	23. Furnizim me dhera dhe mbulimi i mbeturinave	80,000.00	50,000.00 €	51,000.00 €	52,020.00 €
	24. Shërbimet e transportit për ngarkim dhe bartje të mbeturinave	9,900.00	12,000.00 €	12,240.00 €	12,484.80 €
	25. Shpenzimet e riparimit, mirëmbajtjes së makinerisë së rëndë	145,000.00	122,000.00 €	124,440.00 €	126,928.80 €
	26. Furnizimi dhe servisi i aparateve kundër zjarrit	12,875.00	12,875.00 €	13,132.50 €	13,395.15 €
	27. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve	5,000.00	6,000.00 €	6,120.00 €	6,242.40 €
	28. Shpenzimet për derivate të naftës	351,000.00	350,000.00 €	357,000.00 €	364,140.00 €
	29. Shpenzimet për vajra	30,000.00	30,000.00 €	30,600.00 €	31,212.00 €
	30. Shpenzimet për filtra	16,950.00	16,950.00 €	17,289.00 €	17,634.78 €
	31. Servisi dhe kalibrimi i njëhësorve të naftës	1,000.00	1,000.00 €	1,020.00 €	1,040.40 €
	32. Servisi, kalibrimi dhe mirëmbajtja e peshoreve ekzistuese	4,600.00	4,600.00 €	4,692.00 €	4,785.84 €
	33. Furnizimi me goma për makineri dhe automjeteve	22,000.00	22,000.00 €	22,440.00 €	22,888.80 €
	34. Shërbimet e saldimit për kontejner në STF	1,000.00	1,200.00 €	1,224.00 €	1,248.48 €
	35. Shpenzimet për kryerjen e analizave të ujit në lagunat e DS-ve	15,000.00	24,000.00 €	24,480.00 €	24,969.60 €
	36. Transporti i makinerisë së rëndë 1000km	-	5,000.00 €	5,100.00 €	5,202.00 €
	37. Shpenzimet e kontrollave rutinore dhe specifike në deponi	-	3,000.00 €	3,060.00 €	3,121.20 €
	38. Shpenzimet administrative	149,598.00	130,389.63 €	132,997.42 €	135,657.37 €
	39. Shpenzimet e shërbimeve të udhëtimit	12,000.00	12,000.00 €	12,240.00 €	12,484.80 €
	40. Auditimi i pasqyrave financiare	4,000.00	5,000.00 €	5,100.00 €	5,202.00 €
	41. Shpenzimet e shërbimeve të konsulentëve	10,000.00	35,000.00 €	35,700.00 €	36,414.00 €
	42. Shpenzimet e reprezentacionit dhe përfaqësimit	10,500.00	10,560.00 €	10,771.20 €	10,986.62 €
	43. Çertifikimi i pasqyrave financiare	-	800.00 €	816.00 €	832.32 €
	44. Shpenzime të pa parashikuara	120,000.00	150,000.00 €	153,000.00 €	156,060.00 €
	45. Trajnim për stafin, ngritje profesionale dhe edukimi i vazhdueshëm	6,000.00	8,000.00 €	8,160.00 €	8,323.20 €
	46. Shpenzimet e zhvendosjes dhe bartjes së inventarit	2,500.00	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	47. Shpenzimet e suvatimit dhe kthimit në gjendjen fillestare të objektit	9,500.00	0.00 €	0.00 €	0.00 €
	48. Shërbimet e konsulentëve juridikë dhe të përfaqësimit	20,000.00	25,000.00 €	25,500.00 €	26,010.00 €
	Totali i shpenzimeve operative (SEK.D)	2,233,096.33	2,350,054.62€	2,385,525.86€	2,422,061.24 €
DH	III. Fitimi operativ para zhvlerësimit (C-D)	1,579,320.94	1,497,582.38 €	1,912,002.39 €	2,395,651.77 €
	IV .Amortizimi-shpenzimet e zhvlerësimit	720,497.00	585,218.00 €	615,000.00 €	645,000.00 €
	V. Fitimi/humbja para të hyrave jo operative (III-IV)	858,823.94	912,364.38€	1,297,002.39€	1,750,651.77 €

VI. Të hyrat jo-operative	4,400.00	3,400.00€	400.00 €	-
VIII. Fitimi/humbja e vitit para tatimit: (V-VI-VII)	863,223.94	915,764.38€	1,297,402.39 €	1,750,651.77 €

7.2 Planifikimi buxhetor për vitin 2025

Planifikimi buxhetor vitin 2025 reflekton një planifikim të detajuar të të hyrave dhe shpenzimeve mujore të KMDK-së, duke filluar me një saldo fillestare prej 1,550,000 €. Kjo pasqyron një përputhje të qëndrueshme mes të ardhurave të planifikuara dhe shpenzimeve, për të siguruar që operacionet të financohen në mënyrë adekuate gjatë gjithë vitit.

Të hyrat kryesore për vitin 2025 janë parashikuar të jenë 3,757,848.29 €, me një rrjedhë të ardhurash të qëndrueshme çdo muaj. Këto të hyra përfshijnë të ardhurat nga aktivitetet kryesore të menaxhimit të mbeturinave, të ardhura nga interesat dhe të ardhura të tjera nga operacionet shtesë.

Në anën tjetër, shpenzimet kryesore përfshijnë amortizimin prej 585,218.04 € dhe shpenzime të ndryshme operationale, duke përfshirë paga, shpenzimet për shërbime konsulence, auditime, shpenzime administrative dhe shpenzime të paparashikuara. Do theksuar që ndërmarrja ka nevojë për rivlerësimin e aseteve gjë që do ta kryej gjatë vitit 2025. Për shembull, shpenzimet për paga janë planifikuar në 1,153,920.80 € për vitin 2025, që ka për objektiv joshjen e stafit profesional në ndërmarrje.

Shpenzimet operative në deponi arrijnë në 881,625.00 €, duke përfshirë mirëmbajtjen e makinerive të rënda, furnizimin me derivate, riparime, dhe shpenzime të tjera specifike të nevojshme për operacionet e përditshme.

Në përmblidhje, buxheti për vitin 2025 synon të mbajë një balancim të kujdesshëm midis të ardhurave dhe shpenzimeve për të siguruar një funksionim të qëndrueshëm të KMDK-së gjatë gjithë vitit, duke përmblusur nevojat operationale dhe financiare të ndërmarrjes.

Tabela 5. Buxheti për vitin 2025

Buxheti i planifikuar për vitin 2025														
Nr.	Pozicionet e planifikuara	Total Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1.	Saldo fillestare	1,550,000.00	1,550,000.00	1,137,957.44	1,229,401.88	1,276,290.79	1,086,670.46	1,003,783.54	954,268.62	1,016,623.99	1,225,760.70	1,364,902.13	1,447,503.09	1,137,957.44
2.	Amortizimi	585,218.04	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17	48,768.17
3.	Të hyrat	3,757,848.29	278,067.65	259,379.40	276,066.55	289,863.01	303,733.92	301,965.58	370,255.63	427,496.04	335,532.08	311,319.99	301,393.70	302,774.75
4.	Totali i të hyrave tjera (6+7+8+9)	84,788.64	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72	7,065.72
5.	Të hyrat tjera operative	5,000.00	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67	416.67
6.	Amortizimi	(585,218.04)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)	(48,768.17)
7.	Çertifikimi i pasqyrave financiare	(800.00)			(800.00)									
8.	Auditimi i pasqyrave financiare	(5,000.00)				(5,000.00)								
9.	Shpenzimet e shërbimeve të udhëimit	(12,000.00)	(12,000.00)											
10.	Shpenzimet e shërbimeve të konsulencës	(35,000.00)	(35,000.00)											
11.	Shërbime të konsulencës juridike	(25,000.00)	(25,000.00)											
12.	Trajnim për stafin, ngritje profesionale dhe edukimi i vazhdueshëm	(8,000.00)		(1,000.00)	(1,000.00)	(1,000.00)	(1,000.00)	(1,000.00)			(1,000.00)	(1,000.00)	(1,000.00)	
13.	Shpenzimet e paparashikuara	(150,000.00)	(150,000.00)											
14.	Pagat	(1,167,680.00)	(98,082.65)	(99,213.48)	(97,494.38)	(96,759.38)	(96,759.38)	(96,759.38)	(96,759.38)	(97,200.38)	(98,373.48)	(96,759.38)	(96,759.38)	(96,759.38)
15.	Shpenzimet operative në depoti	(810,625.00)	(41,282.50)	(40,972.50)	(66,137.50)	(80,575.00)	(70,337.50)	(88,102.50)	(84,482.50)	(97,802.50)	(64,482.50)	(74,175.00)	(59,637.50)	(42,637.50)

16.	Shpenzimet administrative	(130,390.05)	(8,089.45)	(18,851.35)	(10,348.15)	(8,251.35)	(7,126.35)	(7,221.00)	(7,260.78)	(7,958.84)	(10,137.04)	(30,387.04)	(7,871.66)	(6,887.01)
17.	Shpenzimet e reprezentacionit	(10,560.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)	(880.00)
18.	Investimet	(994,500.00)	(12,500.00)	(14,500.00)	(60,000.00)	(294,500.00)	(218,000.00)	(165,000.00)	(126,000.00)	(22,000.00)	(29,000.00)	(33,000.00)	(12,000.00)	(8,000.00)
19.	Kontingjencat nga pasqyra e të ardhurave	(314,758.00)	(314,758.00)											
Totali i buxhetit (pozitat 01-19)		1,733,323.89	1,137,957.44	1,229,401.88	1,276,290.79	1,086,670.46	1,003,783.54	954,268.62	1,016,623.99	1,225,760.70	1,364,902.13	1,447,503.09	1,578,230.64	1,733,323.89

7.3 Shpenzimet e deponive sanitare në KMDK

Shpenzimet për deponitë sanitare në KMDK për vitin 2025 përfshijnë një gamë të gjerë aktivitetesh të nevojshme për të mbajtur infrastrukturën operative dhe për të garantuar funksionimin efikas të menaxhimit të mbeturinave. Një nga shpenzimet më të mëdha për vitin 2025 është angazhimi i makinerisë për shtyrjen dhe rregullimin e mbeturinave, për të cilën janë ndarë 100,000 euro. Ky buxhet siguron që mbeturinat të trajtohen në mënyrë efektive dhe deponitë të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme, duke përmirësuar jetëgjatësinë e tyre. Kjo do të sigurojë që KMDK kryen operimet edhe kur ka prishje të makinerisë. Për mbulimin e mbeturinave me dhe është planifikuar një buxhet prej 50,000 euro, duke siguruar mbulimin sipas standardeve mjedisore për të minimizuar ndikimet negative në ambient. Do theksuar që KMDK ka larguar praktikën e blerjes së shtrenjtë të dheut e praktikuar në të kaluarën.

Në vijim të këtyre, riparimi dhe mirëmbajtja e makinerive të rënda, të cilat janë thelbësore për operacionet e përditshme të deponive, ka rezervuar 122,000 euro. Këto shpenzime mbulojnë riparimet e prishjeve të paparashikueshme dhe mirëmbajtjen periodike të makinerive që përdoren për të menaxhuar dhe mbuluar mbeturinat.

Një prej shpenzimeve kryesore është D.D.D. (Dezinsektimi, Deratizimi dhe Dezinfektimi), i cili është planifikuar në shumën prej 20,000 eurosh, të cilat do të shpërndahen gjatë vitit për të siguruar kontrollin e rregullt të higjienës dhe shëndetit publik në deponitë, që është një reduktim serioz nga rreth 75,000 euro sa janë shpenzuar në të kaluarën.

Një tjetër shpenzim i rëndësishëm është furnizimi me dru për ngrohje, i cili është parashikuar në 7,500 euro, duke mbuluar nevojat për ngrohje të objekteve në deponi gjatë sezonit të ftohtë. Po ashtu, angazhimi i operatorit ekonomik për trajtimin e ujërave të zeza në kolektorin e stacionit të transferit do të kushtojë 17,500 euro.

Këto shpenzime janë planifikuar me kujdes për të mbuluar nevojat operationale gjatë vitit 2025, duke siguruar që deponitë sanitare të funksionojnë pa ndërprerje dhe në përputhje me kërkesat rregullatore dhe standardet mjedisore. Shpenzimet janë thelbësore për garantimin e sigurisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së operationeve të KMDK-së në deponitë sanitare, duke mbajtur një balancë midis kostove dhe nevojave operationale.

Tabela 6. Shpenzimet e deponive sanitare dhe stacionit te transferit

Shpenzimet e deponive sanitare													
Emërtimi	Vlera financiare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Kurrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Shërbimet D.D.D	20,000.00				10,000.00				10,000.00				
Furnizim me dru për ngrohje	7,500.00						7,500.00						
Angazhimi i OE për trajtimin e ujërave të zeza	17,500.00	1,800.00	1,800.00	1,500.00	1,500.00	1,200.00	1,000.00	1,000.00	1,200.00	1,000.00	1,500.00	2,000.00	2,000.00
Angazhimi i makinerisë për shtyerje të mbeturinave rregullimin e skarpave në formë piramide për rrirjen e jetë qatësish së deponive	100,000.00	3,000.00	3,000.00	5,000.00	7,000.00	10,000.00	16,000.00	16,000.00	16,000.00	10,000.00	7,000.00	4,000.00	3,000.00
Furnizim me dhera për mbulimin e mbeturinave	50,000.00			4,000.00	5,000.00	7,000.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00	4,000.00	4,000.00	2,000.00	
Shërbimet e transportit për ngarkim dhe barje të mbeturinave	12,000.00							5,000.00	7,000.00				
Shpenzimet e riparimit mirëmbajtjen e makinerisë së rëndë	122,000.00	2,000.00	4,000.00	12,000.00	14,000.00	14,000.00	14,000.00	14,000.00	14,000.00	15,000.00	15,000.00	2,000.00	2,000.00
Servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit	12,875.00				6,437.50						6,437.50		
Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve	6,000.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00
Vajra për makineri të rëndë	30,000.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00	2,500.00
Filtera për makineri të rëndë	16,950.00	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50	1,412.50
Servisimi dhe kalibrimi i nënshoreve të naftës	1,000.00				1,000.00								
Servisimi, kalibrimi dhe mirëmbajtja e peshoreve ekzistuese	4,600.00										4,600.00		
Furnizimi me goma për makinerinë dhe automjete	22,000.00			8,000.00								14,000.00	
Shërbimet për saldimin e kontrinjereve në STF	1,200.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00

7.4 Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale të planifikuara për vitin 2025 në KMDK përfshijnë një sërë aktivitete të rëndësishme për të mbështetur funksionimin e përditshëm të kompanisë. Këto shpenzime përfshijnë kostot për qiranë e zyrave, shpenzimet e komunikimit, energjinë elektrike, ujin, materialet e nevojshme për zyrë, si dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe infrastrukturës teknologjike.

Një pjesë e madhe e shpenzimeve operacionale përbëhet nga qiraja e zyrave, e cila është parashikuar në 30,508.47 euro për vitin 2025. Përveç kësaj, shpenzimet për telefoninë mobile dhe shërbimet e internetit, të cilat janë jetike për komunikimin dhe koordinimin e përditshëm, janë parashikuar të jenë 6,864.41 euro dhe 3,406.78 euro, respektivisht.

Një tjetër zë i rëndësishëm është shpenzimi për energjinë elektrike, i cili arrin në 9,444.44 euro, duke mbuluar nevojat energjetike të objekteve të KMDK-së gjatë gjithë vitit. Për materialet e konsumueshme për zyrë janë paraparë 8000.40, si dhe për shërbimet e mirëmbajtjes së faqes së internetit dhe emailave janë paraparë të shpenzohen 3,000.00 euro, përkatësisht, për të siguruar funksionalitetin e vazhdueshëm dhe operacionet pa ndërprerje.

Shpenzime të tjera përfshijnë publikimet zyrtare, sigurimin e automjeteve dhe mirëmbajtjen e automjeteve, të cilat janë thelbësore për operacionet në terren. Për shembull, janë planifikuar 2,499.96 euro për publikimet zyrtare dhe 3,999.03 euro për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve.

Në tërësi, shpenzimet operacionale për vitin 2025 janë parashikuar të arrijnë në 130,640.05 euro, duke siguruar një balancë të qëndrueshme mes nevojave administrative dhe burimeve të nevojshme për operacionet e përditshme të KMDK-së. Këto shpenzime janë thelbësore për garantimin e funksionimit të pandërprerë dhe të suksesshëm të kompanisë, duke mbuluar të gjitha aspektet kritike të administratës dhe operacioneve.

Tabela 7. Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale														
Përshkrimi i aktivitetit		Total	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1.	Qiraja për zyrë (bruto)	30,508.47	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37	2,542.37
2.	Shpenzimet e telefonisë mobile	6,864.41	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03	572.03
3.	Shpenzimet e internetit, tel fiks dhe kabllovik përfshirë DS dhe ST	3,406.78	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90	283.90
4.	Shpenzimet për energji elektrike	9,444.44	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04	787.04
5.	Shpenzimet për ujë dhe mbeturina	500.00	41.67	41.67	41.67	41.67	41.67	41.67	41.67	41.67	41.66	41.66	41.66	41.66
6.	Shpenzimet për material hargjues për zyrë	8,000.40	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70	666.70
7.	Shpenzimet për web faqe dhe mirëmbajtjen e emailve	3,000.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00
8.	Shpenzimet për publikim zyrtar (shpallje)	2,499.96	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33	208.33
9.	Shpenzimet për material higjienik	6,000.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00	500.00
10.	Shpenzimet për ujë dhe qumësht	4,000.00	333.33	333.33	333.33	333.33	333.33	333.33	333.33	333.33	333.34	333.34	333.34	333.34
11.	Shpenzimet për sigurim të automjeteve dhe regjistrim në QAK	3,999.03	263.10		971.80			333.96	373.74	1,071.80			984.63	
12.	Bileta për udhëtime zyrtare	3,000.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00	250.00
13.	Shpenzimet për sigurim të objektit	786.55	59.31	59.31	59.31	59.31	59.31	70.00	70.00	70.00	70.00	70.00	70.00	70.00
14.	Hulumtimi për kënaqësinë e konsumatorve	1,000.00		1,000.00										
15.	Bllokat e peshimit për deponi	1,500.00				750.00					750.00			
16.	Shpenzim për marrje të veturave me qera	480.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00	40.00
17.	Servisimi i printerave	950.00	950.00											
18.	Laria e automjeteve të KMDK-së	600.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00
19.	Kontrolli sistematik për punëtorë	3,500.00										3,500.00		

7.5 Pagat në KMDK

Në vitin 2025, shpenzimet për pagat në KMDK janë planifikuar për të mbuluar nevojat e stafit dhe për të siguruar një shpërndarje të qëndrueshme të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet e operacioneve të kompanisë. Në total, shpenzimet për pagat e punonjësve të KMDK-së për vitin 2025 janë parashikuar të arrijnë në 1,153,920.80 euro. Ky buxhet mbulon të gjitha detajet që lidhen me pagat, përvojën e punës, sigurimet shëndetësore dhe pensionet, duke siguruar një shpërndarje të qëndrueshme dhe transparente të resurseve financiare për stafin gjatë gjithë vitit. Sidoqoftë, plani nuk merr parasysh ristrukturimin e planifikuar dhe rritjen në diskutim të pagave. Rezultat i ristrukturimit do të jetë një plan i ri kategorizimit dhe strukturimit të pagave në ndërmarrje.

Pagat bruto bazë për stafin janë parashikuar të arrijnë në 831,871.66 euro për vitin 2025, të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë dymbëdhjetë muajve të vitit. Përveç kësaj, përvoja e punës është llogaritur me një shtesë prej 0.5% për çdo vit pune, që sjell një total prej 56,865.00 euro për këtë kategori.

Një komponent tjetër i rëndësishëm është shujta e caktuar për punonjësit, e cila arrin në 104,832.00 euro në total për vitin 2025, duke mbështetur mirëqenien e stafit. Po ashtu, janë planifikuar edhe shpenzimet për orët shtesë dhe stimulimet, që kapin shumën prej 54,903.53 euro, duke përfshirë kompensimet për punë jashtë orarit dhe bonuset për performancën, kjo duke pasur parasysh operimin 24/7 të deponive dhe stacionit të transferit.

Shpenzimet për pagat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve janë llogaritur në 20,160.00 euro për vitin 2025. Në të njëjtën kohë, kompania ka planifikuar edhe pagesën e pagave jubilarë për punonjësit me shërbim të gjatë, që arrin në 2,530.00 euro.

Sigurimet shëndetësore të punonjësve për vitin 2025 janë llogaritur në 27,810.00 euro, ndërsa kontributet pensionale, që mbulojnë 5% të pagës nga punëdhënësi, janë planifikuar në 54,948.61

Tabela 8. Shpenzimet e pagave*

Shpenzimet e pagave													
Përshkrimi													
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Total
Pagat bruto bazë	9,641.46	0,473.53	9,031.46	9,031.46	9,031.46	9,031.46	9,031.46	9,031.46	0,473.53	9,031.46	9,031.46	69,031.46	831,871.66
Përvoja e punes 0.5% (vjetore)	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	4,738.75	56,865.00
Shujtat € 4	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	8,736.00	104,832.00
Orët shtesë dhe stimulimet	4,596.34	4,651.25	4,556.08	4,556.08	4,556.08	4,556.08	4,556.08	4,556.08	4,651.25	4,556.08	4,556.08	4,556.08	54,903.53
Pagat bruto të BD	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	1,680.00	20,160.00
Pagat jubilarë	610.00	800.00	700.00					420.00					2,530.00
Sigurimet shëndetësore	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	2,317.50	27,810.00
Kontributet pensionale	4,616.00	4,669.85	4,587.99	4,552.99	4,552.99	4,552.99	4,552.99	4,573.99	4,629.85	4,552.99	4,552.99	4,552.99	54,948.61
Total Paga	6,936.05	8,066.88	6,347.78	5,612.78	5,612.78	5,612.78	5,612.78	6,053.78	7,226.88	5,612.78	5,612.78	95,612.78	1,153,920.80

* Shënim: Kjo tabelë paraqet pagat sipas niveli aktual dhe nuk merr parasysh ristrukturimin dhe rritjen potenciale të planifikuar.

Tetor	14,391.52	363.97	14,755.49	9,460.20	-	9,460.20	3,758.51	4.66	3,763.17	1,549.52	-	1,549.52	2,066.89	43.37	2,110.26	31,226.65	412.00	31,638.65
Nëntor	14,120.42	234.19	14,354.60	9,137.29	7.66	9,144.95	3,546.02	60.50	3,606.52	1,458.76	-	1,458.76	2,309.77	32.97	2,342.74	30,572.26	335.32	30,907.58
Dhjetor	15,760.24	355.82	16,116.06	7,367.58	3.21	7,370.79	3,469.31	1.15	3,470.47	1,424.56	-	1,424.56	2,295.90	50.17	2,346.07	30,317.59	410.36	30,727.95
Total	186,828.54	3,927.02	190,755.60	102,785.92	67.72	102,853.64	46,814.46	81.81	46,896.27	17,875.75	391.44	18,267.18	22,292.91	566.50	22,859.41	376,597.61	5,034.49	381,632.10

*Komentet: Planifikimi i vitit 2024 ka qenë 5% mbi sasitë e vitit 2023

Realizimi në krahasim me vitin 2023 ne sasi: +1%

Propozimi për rritje: +1%

Mesatarja nga periudha 01.01.2020-31.08.2024 - sasia: 370321.63

Mesatarja mujore 01.01.2023-31.08.2024 - propozimi për rritje: 31174.88

Mesatarja mujore 01.01.2024-31.08.2024 - propozimi për rritje: 31327.25

7.7 Investimet

Bazuar në tabelën e investimeve të parapara për vitin 2025, Kompania e Menaxhimit të Deponive të Kosovës ka planifikuar një sërë investimesh të rëndësishme për përmirësimin e operacioneve dhe infrastrukturës. Ky plan përfshin alokimin e fondeve për mirëmbajtjen e makinerive, blerjen e pajisjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës, dhe digjitalizimin e proceseve të ndryshme. Për vitin 2025, janë planifikuar investime të mëdha në disa sektorë kyç.

Investimet më të rëndësishme përfshijnë blerjen e makinerisë në vlerë prej 250,000 euro dhe blerjen e automjeteve, të planifikuara për muajt mars, me një vlerë prej 80,000 euro. Po ashtu, infrastruktura e kompanisë do të përftojë nga një investim prej 300,000 euro, i cili do të përfundojë me objektin administrativ të KMDK-së.

Në aspektin e përmirësimeve teknologjike, KMDK ka planifikuar një investim prej 30,000 euro për digjitalizimin e procesit të faturimit dhe 28,000 euro për digjitalizimin e peshoreve në deponitë e Podujevës dhe STF. Gjithashtu, 40,000 euro janë ndarë për ndërtimin e rrethojave të deponive, dhe 16,000 euro për vendosjen e gypave të ajrosjes.

Ky plan investimesh synon të përmirësojë efikasitetin operacional të KMDK-së, të modernizojë pajisjet dhe infrastrukturën, si dhe të sigurojë që kompania të jetë në përputhje me praktikat më të mira të menaxhimit të deponive dhe mjedisit.

Tabela 15. Investimet e parapara për vitin 2025

Investimet													
Emërtimi	Vlera financiare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershorë	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1. Investimet për pjesë rezervë (mirëmbajtja e makinerisë)	140,000.00	10,000.00	8,000.00	11,000.00	15,000.00	8,000.00	18,000.00	14,000.00	18,000.00	12,000.00	14,000.00	8,000.00	4,000.00
2. Blerja e makinerisë	250,000.00				250,000.00								
3. Blerja e automjeteve (veturave)	80,000.00					80,000.00							
4. Infrastruktura e KMDK-së	300,000.00					100,000.00	100,000.00	100,000.00					
5. Vegla pune për hortikulturë	1,500.00		1,500.00										
6. Vegla pune për mekanikë	2,500.00		2,500.00										
7. Aparat saldimi	2,000.00			2,000.00									
8. Program softwareik	30,000.00						30,000.00						
9. Rrethojat e deponive 4x 10000	40,000.00				10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00					
10. Gropa të ajrosjes 4x100	16,000.00				8,000.00						8,000.00		
11. Dixhitalizimi i peshoreve në Podievë dhe STF	28,000.00			14,000.00						14,000.00			
12. Dixhitalizimi i procesit të faturimit	30,000.00			30,000.00									

